



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I SHKENCAVE DHE
TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE

**SATISFAKSIONI DHE NEVOJAT E NXËNËSVE PËR TË
MËSUAR. RAST STUDIMI: SHKOLLAT E MESME TË
KOMUNËS SË TETOVËS**

PUNIMI I MAGJISTRATURËS

Kandidati:
Flora Rustemi

Mentori:
Prof. dr. Halil Snopçe

Tetovë, Maj 2019

Deklaratë statuore

Unë deklaroj nën përgjegjësi të plotë se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Flora Rustemi

Falënderime

Falemnderoj dhe i jam mirënjohës mentorit tim Prof. dr. Halil Snopçes, i cili me idetë dhe mbështetjen e veçantë më ndihmoi të përfundoj me sukses këtë punim kaq me vlerë për mua.

Një falemnderim të veçantë kam për shkollat e mesme të Komunës së Tetovës, respektivisht drejtorave të këtyre shkollave të cilët me kontributin e tyre më mundësuan mbledhjen e të dhënave për qëllimin e këtij punimi.

Poashtu, mirënjohje dhe falemnderim të veçantë kam për nxënësit që morrën pjesë në anketim dhe treguan gatishmëri për të dhënë kontributin e tyre në realizimin me sukses të objektivave të këtij hulumtimi.

Së fundmi, jam shumë mirënjohëse ndaj familjes time për gjithë mbështetjen, durimin dhe mirëkuptimin që më kanë dhënë për të realizuar dhe përfunduar me sukses këtë studim.

Abstrakt

Në mbarë botën, kapitali njerëzor është elementi më i fortë që përfaqëson rritjen ekonomike. Investimi në zhvillimin e kapitalit njerëzor të një vendi përmes arsimit, ka një ndikim të qartë pozitiv në rritjen dhe pasurinë e çdo kombi (Coleman, 2005). Arsimi i mesëm është perceptuar si një nga instrumentet më të rëndësishme për zhvillimin individual, social dhe ekonomik të një vendi. Ai po merret me sfida dhe çështje të ndryshme në të gjithë botën sidomos në vendet më të zhvilluara. Me ligjin për shkollim të mesëm të detyrueshëm, sektori i arsimit po zgjerohet edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Këto reforma arsimore kanë çuar tashmë në një rritje të dukshme dhe konkurrencë në sektorin e arsimit të mesëm , të cilat kërkojnë që të miratohet një strategji orientimi për të dalluar shërbimet e tyre nga konkurrentët, në mënyrë që të rriten regjistrimet dhe të tërheqin sa më shumë nxënës.

Në këtë studim merremi me faktorët që lidhen me satisfaksionin e nxënësve duke u përqëndruar në nevojat e tyre. Ndër to , si më të rëndësishëm do të përmendim: përshtypjen e përgjithshme të shkollës, profesionalizmin e mësimdhënësve dhe interesin për lëndën e tyre, mjedisin mësimor dhe objektet në klasë, tekstet shkollore, ndjekjen e vazhdueshme të përparimit dhe vlerësimit, cilësinë dhe qasjen e teknologjisë informative (IT) në metodat e mësimdhënies, stafin administrativë dhe infrastrukturën. Hulumtimi përfshin metodologjinë cilësore dhe sasiore. Përgjigja e nxënësve është matur përmes një pyetësoi të përshtatur në një shkallë 5 pikëshe të *Likertit*. Madhësia e mostrës së studimit përbëhet nga 196 nxënës që u përkasin shtatë shkollave të mesme dhe një fillore të Komunës së Tetovës. Rezultatet u analizuan duke përdorur softuerin statistikor SPSS (Statistical Package for the Social Sciences) dhe tregojnë se të gjitha variablat e përmendura më sipër kanë ndikim të ndjeshëm dhe pozitiv në satisfaksionin e nxënësve me arsimin e mesëm edhe pse me shkallë të ndryshme të nivelit të kënaqësisë.

Fjalë kyçe: Shkolla, nxënësit, satisfaksioni i nxënësve, nevojat e nxënësve, cilësia e mësimdhënësve, metodat e mësimdhënies, stafi administrativ, vlerësimi, vet-vlerësimi.

Апстракт

Во светот, човечкиот капитал е најсилниот елемент на економскиот раст. Инвестирањето во развојот на човечкиот капитал на нацијата преку образование, има јасно позитивно влијание врз растот и богатството на секоја нација (Coleman, 2005). Средното образование се смета за еден од најважните инструменти за индивидуален, социјален и економски развој на една земја и се занимава со разни предизвици и прашања низ целиот свет, особено во најразвиените земји. Со законот за задолжително средно образование, образовниот сектор се проширува во Република Северна Македонија. Овие образовни реформи веќе доведоа до очигледен пораст и конкуренција во секторот на средно образование, кои се обидуваат да усвојат стратегија за ориентација за да ги разликуваат нивните услуги од конкурентите, со цел да се зголемат регистрациите и да се привлечат повеќе студенти.

Во оваа студија се занимаваме со фактори поврзани со задоволството на учениците, фокусирајќи се на нивните потреби. Меѓу нив, најважните ќе бидат споменати: општиот впечаток на училиштето, професионализам на наставниците и интересот во нивниот предмет, средината за учење и објектите на училница, учебници, континуирано следење на напредокот и евалуација, квалитетот и пристапот во информативна технологија (ИТ) за наставните методи, административниот персонал и инфраструктурата. Истражувањата вклучуваат квалитативна и квантитативна методологија. Одговорот на ученикот беше мерен преку прашалник прилагоден на скалата од 5 точки на *Likert*. Големината на примерокот на студијата се состои од 196 ученици од седум средни училишта и едно основно училиште во Тетово. Резултатите беа анализирани со помош на SPSS статистички софтвер (Статистички пакет за општествени науки) и да покаже дека сите променливи споменати погоре има значајно и позитивно влијание врз задоволството на учениците иако со различни степени на нивото на задоволство.

Клучни зборови: ученици, задоволство на учениците, потребите на учениците, квалитетот на наставниците, наставни методи, административен кадар, оценување, самооценување.

Abstract

Worldwide, human capital is the strongest element representing economic growth. Investing in the development of a nation's human capital through education has a clear positive impact on the growth and wealth of each nation (Coleman, 2005). Secondary education is perceived as one of the most important instruments for individual, social and economic development of a country. It is dealing with various challenges and issues all over the world, especially in the most developed countries. With the Law on compulsory secondary education, the education sector is expanding in the Republic of North Macedonia as well. These educational reforms have already led to an apparent increase and competition in the secondary education sector, which seek to adopt an orientation strategy to distinguish their services from competitors in order to increase registrations and attract more students.

In this study, we deal with factors related to student satisfaction by focusing on their needs. Among them, most importantly we will mention: general school impression, teachers professionalism and interest in their subjects, teaching environment and classroom facilities, textbooks, continuous tracking of progress and assessment, quality and access of information technology (IT) on teaching methods, administrative staff and infrastructure. Research involves qualitative and quantitative methodology. The student response was measured through a questionnaire adapted to a 5-point scale of *Likert*. The sample size of the study consists of 196 students belonging to seven high schools and a primary school in the municipality of Tetovo. The results were analyzed using the Statistical Package for the Social Sciences (SPSS) and show that all the variables mentioned above have a significant and positive impact on the satisfaction of the students with the secondary education although with varying degrees of satisfaction.

Key words: School, students, student satisfaction, student's needs, teachers' quality, teaching methods, administrative staff, assessment and self-assessment.

PËRMBAJTJA

Falënderime	3
Abstrakt.....	4
Апстракт	5
Abstract	6
1. HYRJE.....	9
1.1 Përkufizimi i satisfaksionit	10
1.2 Qëllimi i të mësuarit në shkollë	11
1.3 Qëllimi i punimit	12
2. Rishikimi i literaturës	14
2.1 Korniza konceptuale	20
3. METODOLOGJIA.....	22
3.1. Hipotezat e hulumtimit	22
3.2. Metodat, teknikat dhe procedurat e zbatuara	23
3.3. Instrumentet e hulumtimit	23
3.4. Popullimi i studimit dhe format e analizës së të dhënave	24
4. REZULTATET E STUDIMIT	27
4.1. Cilësia e bashkëveprimeve me të gjithë punonjësit e shkollës	30
4.2 . Cilësia e mjedisit mësimor në klasë	38
4.3 Eksperienca mësimore në shkollë	47
4.4. Vlerësimi i nxënësve dhe vet-vlerësimi	54
4.5. Vlerësimi në lidhje me ndikimin e faktorëve tjerë relevant me ndikim (influencë)	59
5. DISA VARSHMËRI TË RËNDËSISHME	62
5.1. Kros-tabulimet dhe disa varshmëri signifikante	62
5.2 Analiza e regresionit dhe korelacionit	75
6. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	84
6.1 Përfundimet	84
6.2 Rekomandimet	85

<i>6.3 Përfundim përmbyllës</i>	87
REFERENCAT	88
Shtojca 1: PYETËSOR	93

KAPITULLI I PARË

1. HYRJE

Sot, arsimi qëndron para një pikë kthese të madhe. Akoma nuk janë të dukshme perspektivat e largëta, por sigurisht që ndryshime të mëdha do të ndodhin dhe do ta prekin funksionin themelor të shkollës. Që t'i përgjigjet rolit të ri, shkolla duhet të kalojë nëpër disa procese operative, të kësaj strategjie për arritje të qëllimeve dhe vazhdimisht të ndërtojë kapacitete të reja. Shkollat duhet ta përshtatin programin edukativo-arsimor për të krijuar satisfaksion, t'i plotësojnë nevojat e nxënësve, të zhvillimit, interesave të tyre dhe kjo do të ndikojë shumë mbi atë se çfarë do të mësohet e çfarë do të ligjerohet.

Shkollimi i mesëm i detyrueshëm dhe globalizimi e zhvillimi i hovshëm i digjitalizimit në anën tjetër, i bën të shkuara ditët kur mësimdhënësi ka qenë burim i vetëm i informacionit në klasë, andaj lind kërkesa për metodologji më të mira të mësimdhënies, më të larmishme dhe më aktuale. Që këto metoda të aktualizohen duhet ditur edhe faktorët që ndikojnë në satisfaksionin dhe nevojat e nxënësve për të mësuar, me qëllim që të rruhet niveli dhe cilësia e procesit edukativo- arsimor sepse shkolla e mesme luan rol kyç jo vetëm në parapërgatitjen profesionale por në të nxënësit rriten dhe zhvillohen në mënyrë shoqërore, emocionale fizike dhe shpirtërore.

Ndjenja pozitive e nxënësve rrit besimin dhe angazhimin në mësim. Konteksti efektiv arsimor kërkon nivel më të lartë të satisfaksionit të nxënësve, mësuesve dhe prindërve (Afzal Muhammad Tanveer, 2015). Satisfaksioni është i lidhur me arritjen. Shumë studiues janë përpjekur të lidhin satisfaksionin dhe nevojat e nxënësve me arritjen. Satisfaksioni i nxënësve

është perceptimi i tyre se sa mirë një atmosferë e shkollës mbështet suksesin arsimor. Kënaqësia e fuqishme aktivizon arsyetimin dhe mësimin analitik të nxënësve. Arritjet dhe kënaqësia me përvojën e tyre është kënaqësia e tyre. Kënaqësia e nxënësve ndikon në motivimin e tyre, i cili është një faktor i rëndësishëm psikologjik në suksesin e tyre. Të gjithë nxënësit vijnë nga familje të ndryshme me botekuptime të ndryshme. Idealet, pikëpamjet dhe stilet e të nxënësve mund të tregojnë nivele të larta dhe të ulëta të kënaqësisë në një temë të caktuar. Niveli i ulët i kënaqësisë tregon mosbalancimin dhe pabarazinë ndërmjet sfidave në një lëndë të caktuar dhe aftësive të nxënësve për të përballuar këto sfida, ndërkohë që niveli i lartë i kënaqësisë së nxënësve rritë të nxënësve të tyre. Nxënësit e kënaqur janë më të angazhuar për studimet e tyre dhe janë të etur për të bërë më shumë përpjekje se sa nxënësit e pakënaqur.

1.1 Përkufizimi i satisfaksionit

Satisfaksioni është ndjenja e lumturisë që fitohet kur personi i plotëson nevojat dhe dëshirat e tij/saj. Është një ndjenjë e ndjerë nga një person që ka përjetuar një performancë ose një rezultat që ka përmbushur pritjet e tij. Prandaj, satisfaksioni mund të përkufizohet si një përvojë e përmbushjes së rezultateve të pritura (Hon, 2002).

Personi do të ndjejë satisfaksion kur ai / ajo të arrijë pritjet, prandaj është një arritje e qëllimshme që rezulton në kënaqësinë e dikujt. Konsumatorët do të ndjejnë satisfaksion kur shërbimet përputhen me pritjet e tyre. Prandaj, kjo është një funksion i nivelit relativ të pritjes që lidhet me perceptimin e njerëzve. Kur një person e percepton se shërbimi hasi si i mirë, ai do të kënaqet, nga ana tjetër personi do të jetë i pakënaqur kur perceptimi i tij apo saj do të përplasat me pritjen e shërbimit. Prandaj, satisfaksioni është një perceptim i përmbushjes së pëlqyeshme të një shërbimi (Salinda et al., 2017).

1.2 Qëllimi i të mësuarit në shkollë

Procesin dhe fatin e një gjenerate e përcaktojnë shumë faktorë ndër të cilët më të rëndësishëm janë: shkolla e mirë, programet e qëlluara, legjislacioni bashkëkohor dhe kuadri arsimor solid. Të gjitha këto e modelojnë njeriun e ardhshëm, protagonistin e shoqërisë në kohën që vjen. Shkolla duhet të bëhet vend në të cilën nxënësit rriten, por jo vetëm në lartësi dhe jo vetëm të posedojnë shumë dituri por edhe kureshtje, guxim, vetëbesim, pavarësi, gjindshmëri, qëndrueshmëri, durim, aftësi dhe shprehi për respektim dhe kuptim të ndërsjelltë. Shkolla duhet të jetojë me kohën madje edhe t'i paraprijë asaj. Koha duhet të jetojë gjithashtu në shkollë dhe ta ndryshojë atë. Shkolla e cila jeton me kohën e kaluar nuk mund të ndikojë në kohën e ardhshme. Kultura, arsimit, arti, shkenca dhe qytetërimi ynë më së miri zhvillohen dhe afirmohen nëpërmjet shkollës. Arsimimi është zhvillim, arsimimi është përgatitje për jetë, arsimimi është proces shoqëror. Ai është vetë jeta (Xheladin M.,2005).

Varësisht nga zhvillimi i një vendi, demokracia e një vendi, detyrat e shkollës dallojnë edhe atë:

Në Gjermani "Shkolla ka për qëllim ta përparojë zhvillimin e shumëanshëm të personalitetit të nxënësit, t'ju ndihmojë në përvetësimin e diturive dhe shkathtësive themelore për mësim të mëtutjeshëm, ta respektojë individualitetin dhe gjendjen e çdo nxënësi, të zgjojë interesat e nxënësit në fusha të ndryshme dhe ta nxisë satisfaksionin në mësim".

Në Itali qëllimi dhe detyrat e shkollës janë "Zhvillimi i aftësive potenciale, aktivizim të funksioneve motorike, njohëse dhe emocionale-sociale, nxitjen e frymës kreative në mësim, zhvillimin e interesave të llojllojshme, përjetim të suksesit dhe zhvillimin e vetëdijes".

Në Holandë qëllimi dhe detyra e shkollës është "Zhvillimi emocional dhe mental i nxënësit, zhvillimi i kreativitetit dhe përvetësimi i diturive qenësore, shkathtësive sociale – kulturore dhe fizike".

Në Japoni qëllimi dhe detyra nacionale e shkollës është "Zhvillimi i tërësishëm i individit, zhvillimi i mendjes dhe trupit të fortë, individ i cili do ta dojë të vërtetën dhe drejtësinë , aftësi për

t'u ballafaquar me ndryshimet shoqërore, t'i respektojë vlerat individuale dhe punën dhe të ketë kuptim të thellë për përgjegjësinë, të jetë i frymëzuar me shpirt të pavarur, si ndërtues i shtetit dhe shoqërisë paqëndrueshme “.

Në Francë qëllimi i arsimit është definuar kështu “Të formojë njerëz për kohën e ardhshme, të cilët do të jenë të aftë dhe përgjegjës ta bëjnë jetën e tyre personale, jetën qytetare dhe profesionale si dhe të jenë kreativ dhe solidar”.

Në SHBA qëllimi dhe detyrat e shkollës definohej më shkurt “Aftësimi i nxënësve për komunikim dhe zgjidhjen e problemeve, përvetësim të diturive shkencore dhe teknologjike”(Xheladin M., 2005).

1.3 Qëllimi i punimit

Në nivel botëror, e sidomos në vendet e zhvilluara, shkollimit parauniversitar i kushtohet rëndësi të madhe meqë aty shihet edhe ardhmëria e një vendi. Me globalizimin dhe revolucionin e teknologjisë, edhe perceptimi i metodave mësimore nga ana e nxënësve ka ndryshuar. Mësimdhënësi, nxënësi dhe lënda së bashku përbëjnë trekëndëshin e procesit të mësimdhënies dhe mësimin. Së bashku ata krijojnë një klimë klase ku zhvillohet mësimi. Kjo klimë bazohet në shumë faktorë, nga të cilat klima psikologjike është shumë e rëndësishme. Klima psikologjike më tej ka disa komponentë. Ndër to, satisfaksioni i nxënësve dhe nevojat e tyre janë dy prej tyre. Studime të shumta janë kryer për të matur satisfaksionin dhe nevojat e nxënësve për të mësuar me qëllim për të pasur një arsimim sa kuantitativ aq edhe kualitativ. Në faktorët potencial janë identifikuar: përshtypja e përgjithshme e shkollës, përshtypja e përgjithshme e cilësisë së arsimit, profesionalizmi i mësimdhënësve dhe interesi për lëndën e tyre, cilësia dhe qasja e teknologjisë informative (IT).

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut e në veçanti në qytetin e Tetovës, mund të thuhet që fokusi në cilësinë e arsimit të mesëm është relativisht i ulët dhe tema e satisfaksionit dhe nevojave të nxënësve nuk është hulumtuar shumë. Qëllimi bazë i këtij studimi është vlerësimi i

nivelit të satisfaksionit dhe nevojave të nxënësve ndaj shërbimeve të ofruara nga shkollat e mesme të komunës së Tetovës. Një ndër çështjet kryesore që dëshirojmë të analizojmë është se, përderisa kryhet procesi edukativo - arsimor a japin mësimdhënësit maksimumin e duhur gjatë të mësuarit të lëndës përkatëse duke pasur parasysh kohën dhe kushtet në të cilët jetojnë dhe bashkveprojnë adoleshentët e sodit, a janë të përshtatshme dhe të qarta tekstet shkollore, a është i pastër mjedisi mësimor dhe objektet në klasë.

Në bazë të asaj që thamë më sipër, hulumtimi i kësaj teme do të ketë për qëllim që t'i nxjerr në pah kërkesat objektive të nxënësve që do të ndikojnë në satisfaksionin dhe nevojat e tyre si parakusht për një shkollim të suksesshëm.

KAPITULLI I DYTË

2. Rishikimi i literaturës

Qëllimi i këtij rishikimi është të japë të gjithë literaturën konstruktive, në dispozicion për satisfaksionin e nxënësve dhe nevojat e tyre për të mësuar me një sfond teorik . Të dhënat u grumbulluan nga revistat e referuara dhe dokumentet e konferencave dhe janë analizuar në mënyrë konstruktive nga këndvështrime të ndryshme për të filtruar një sfond të shëndoshë për këtë studim. Atëherë, si çdo institucion tjetër biznesi që ofron produktin dhe shërbimet, shkollat sidomos kolegjet dhe universitetet si publike ashtu edhe private janë gjithashtu pjesë e botës së biznesit. Megjithëse ata nuk vendosin produkte të dukshme dhe të prekshme, megjithatë, ato ju ofrojnë shërbime klientëve (Elliot & Dooyong, 2002). Brunat (2006) vërtetoi ekzistencën e një marrëdhënie ndërmjet arsimit dhe rritjes ekonomike të një vendi. Një studim i ri në Journal of Business Research, zbuloi se satisfaksioni i nxënësve në mësim ka një ndikim dramatik, një efekt të drejtpërdrejtë në suksesin e tyre.

Cheng dhe Tam (1997) shpalosnin në mënyrë specifike atë se shkollat ose universitetet mund të tërheqin dhe mbajnë më së miri nxënësit përmes identifikimit dhe plotësimit të nevojave të tyre. Për këtë qëllim, është me rëndësi jetësore që shkollat të identifikojnë dhe ofrojnë atë që është e rëndësishme për nxënësit. Prandaj, Institucionet e Arsimit të mesëm dhe

të lartë, duhet të pranojnë faktin që përderisa ata bëjnë pjesë në industrinë e shërbimit, duhet të vënë theks më të madh në satisfaksionin, përmbushjen e pritjeve dhe nevojave të nxënësve.

Spektori i arsimit po zgjerohet shumë shpejt në të gjithë botën gjatë viteve të fundit. Globalizimi dhe revolucioni dixhital kanë krijuar një kërkesë për disiplina të reja dhe të larmishme në arsim. Kostoja e sigurimit të arsimit është rritur shumë për shkak të metodologjive më të mira të mësimdhënies dhe instrumenteve të mësimin me rritjen e inflacionit në mbarë botën. Rritja e shpejtë e numrit të institucioneve në arsimin e lartë ka çuar në një konkurrencë të fortë. Është themeluar numri i institucioneve të reja dhe regjistrimi është gjithashtu në rritje (Isani & Virk, 2005). Nxënësit mund të marrin informacion lehtë dhe menjëherë për shkak të avancimit në teknologji dhe globalizim. Në këtë mjedis konkurrues vetëm ato institucione mund të shkëlqejnë që ofrojnë arsim cilësor dhe mjedis konstruktiv për nxënësit e tyre, pasi që këta faktorë mund të ndikojnë në zgjedhjen e pranimit të tyre. Faktorë të tillë mund t'i kënaqin nxënësit në institucionet e tyre dhe mund të ndikojnë në vendimet e tyre për të marrë pjesë. Hulumtimi i gjerë është kryer duke studiuar faktorët që mund të ndikojnë në satisfaksionin dhe mbajtjen e nxënësve. Aldridge dhe Rowley (1998) shprehen se sipas këndvështrimit të nxënësve, arsimimi me cilësi të mirë siguron mundësi më të mira të të mësuarit dhe sugjeron që nivelet e kënaqësisë ose pakënaqësisë ndikojnë fuqishëm në suksesin e nxënësit ose dështimin e të mësuarit. Deshields et al. (2005) theksojnë se institucionet e arsimit të lartë po përqëndrohen në identifikimin dhe përmbushjen e nevojave dhe pritjeve të nxënësve të tyre. Faktorë të tillë përfshijnë arritjet akademike të nxënësve, ecurinë e shkollës, mjedisin në klasë, mjediset e mësimin dhe reputacionin e institucionit.

Janë bërë studime të shumta për të matur satisfaksionin e nxënësve me procesin edukativo arsimor në pjesën e zhvilluar të botës (Kashif ur Rahman, 2010). Janë identifikuar faktorë të ndryshëm që mund të ndikojnë potencialisht në satisfaksionin e nxënësve ndaj shërbimeve të ndryshme arsimore të ofruara nga shkollat. Kontaktet joformale të nxënësve me anëtarët e shkollës kanë qenë vazhdimisht të lidhura me vendimet e tërheqjes / këmbënguljes (Terenzini dhe Pasarella, 1980). Mbajtja e nxënësve shpesh konsiderohej si një tregues i kënaqësisë së nxënësve me programin e tyre shkollor dhe, rrjedhimisht, në mënyrë indirekte, cilësinë e arsimit në atë shkollë (Druzdzel & Glymour, 1995).

Në mënyrë të ngjashme, Napoli dhe Wortman (1998) vlerësuan se masat psikologjike, d.m.th ngjarjet që ndodhin në shkollë, vetëvlerësimi, kompetencat sociale, mbështetja sociale, ndërgjegjshmëria personale, mirëqenia psikologjike, satisfaksioni me sistemin e paraparë administrativë dhe social ndikojnë në këmbënguljen e nxënësve për të qëndruar në atë shkollë. Një studim u zhvillua në shkollat gjermane duke përdorur modelin e besnikërisë së nxënësve të bazuar në cilësi të bazuar nga Hennig et al. (2001), i cili zbuloi se cilësia e mësimdhënies dhe angazhimi emocional i studentëve ndaj institucioneve të tyre ishin vendimtare për besnikërinë e nxënësve. Yu dhe Dean (2001) shqyrtuan se si emocionet pozitive, ashtu edhe ato negative dhe komponenti konjitiv i satisfaksionit lidhen me besnikërinë e nxënësve dhe se përbërësi afektiv i kënaqësisë shërben si një parashikues më i mirë se sa faktori njohës.

Palacio et al. (2002) zhvilluan një studim mbi nxënësit spanjollë. Rezultatet zbuluan se imazhi i shkollës ndikoi në satisfaksionin e nxënësve me shkollën dhe plotësimin e nevojave të tyre. Aldemir dhe Gulcan (2004) shqyrtojnë satisfaksionin e nxënësve turq në arsim. Rezultatet e studimit treguan se për disa nxënës turk, cilësia e mësimdhënësve, arsimit, teksteve shkollore, mësimdhënësit të jenë femra dhe të informuar para se të bëheshin pjesë e asaj shkolle u konsideruan si faktorë të rëndësishëm të satisfaksionit të tyre. Për shembull Navarro et al. (2005) anketoj nxënësit spanjollë për kënaqësinë e tyre me ofertat arsimore të bëra nga shkollat. Rezultatet e studimit treguan se stafi mësimdhënës, metodat e mësimdhënies dhe administrimi i lëndëve ishin elemente kyçe për arritjen e satisfaksionit të nxënësve dhe besnikërinë e tyre të mëvonshme.

Mai (2005) studioi satisfaksionin e nxënësve në arsim dhe faktorët e saj me ndikim. U konstatua se përshtypja e përgjithshme e shkollës, përshtypja e përgjithshme e cilësisë së arsimit, ekspertiza e mësuesve dhe interesi i tyre për subjektin e tyre, cilësia dhe qasja e pajisjeve të IT-së dhe perspektivat e shkollës së avancimit të karrierës ishin parashikuesit më me ndikim në kënaqësinë e nxënësve. Në mënyrë të ngjashme Deshields et al (2005) përdori një model satisfaksioni dhe teorinë e dytë të Herzberg për të shqyrtuar përcaktuesit e satisfaksionit të nxënësve me arsimin. Ata zbuluan se performanca dhe klasat ishin faktorët kryesorë që përcaktonin cilësinë e përvojës së kolegjit, gjë që çoi në kënaqësi. Të gjitha këto theksojnë

faktorët e caktuar në ofertat e arsimit të cilat përcaktojnë satisfaksionin e nxënësve me arsimin dhe nga ana tjetër besnikërinë ndaj institucionit.

Në pajtim me Afzal Muhammad Tanveer (2015), nxënësit e kënaqur me mësimin janë më të angazhuar për studimet e tyre dhe janë të etur për të bërë më shumë përpjekje sesa nxënësit e pakënaqur. Ata punojnë më shumë, ndjekin rregullisht procesin mësimor dhe përfundojnë me sukses lëndët e parapara se sa nxënësit e pakënaqur. Satisfaksioni i nxënësve bazohet në përvojat që lidhen me mësimin e tyre. Përvojat arsimore janë rezultat i qëndrimit të përkohshëm të nxënësve. Këto përvoja gjithashtu ndikojnë në kënaqësinë e përgjithshme të nxënësve me shkollën.

Tessema et al. (2012) shqyrtoi efektet e shumë faktorëve që ndikojnë në satisfaksionin e nxënësve. Faktorët kryesorë ishin cilësia e mësimdhënies, përmbajtja kryesore e lëndëve dhe notimi. Këta faktorë u gjetën të rëndësishëm dhe ishin të lidhura pozitivisht me satisfaksionin e nxënësve. Lo (2010) indikoi tre komponentë kryesore të satisfaksionit që mund të parashikojnë të mësuarit e nxënësit. Ato tre faktorë ishin përkatësisht: performanca e mësuesit, angazhimi i nxënësve dhe përmbajtja e lëndëve. Satisfaksion më i lartë u raportua nga Lo (2010) ku mësuesit dhe nxënësit ishin të motivuar në mënyrë të barabartë drejt procesit edukativo mësimor. Sipas Afzal (2015) niveli i kënaqësisë së nxënësve në mësim është një komponent shumë i rëndësishëm për të fituar njohuri ose aftësi. Një nxënës mund të konsiderohet i kënaqur nëse ndjen se mësimi plotëson nevojat dhe pritjet e tij. Kjo mund ta motivojë nxënësin që të bëjë më shumë përpjekje për të mësuar, për të rritur pozitën e tij/saj me qëndrim ndaj mësimin dhe për të ndjekur edhe më tej mësimin në të ardhmen.

Satisfaksioni është bërë një faktor i rëndësishëm që një institucion arsimor të mbijetojë. Në këtë kontekst, Richardson (2005), përdorte shumë dimensione për të matur cilësinë e mjedisit mësimor dhe satisfaksionin e nxënësve. Këto dimensione përfshijnë vlerësimin që japin nxënësit për zhvillimin e procesit mësimor, modulet e lëndëve, perceptimet e cilësisë akademike dhe kënaqësinë e tyre gjatë mësimin. Duque dhe Weeks (2010) treguan se burimet mbështetëse, cilësia arsimore dhe rezultatet e të nxënësve ndikojnë në satisfaksionin e nxënësve në një mënyrë pozitive. Për më tepër, përfshirja e nxënësve ka një impakt të rëndësishëm në rezultatet e të

nxënit, gjë që kontribuon në satisfaksionin dhe nevojat e nxënësit. Pra, është e rëndësishme që të evaluohet rezultati i nxënësit të treguar gjatë mësimit sepse reflekton satisfaksion në të mësuar (Duque dhe Weeks, 2010).

Sipas Nadiri (2011), këshillat akademike dhe udhëzimet efektive ndikojnë në satisfaksionin e nxënësve. O'Driscoll (2012) argumentoi se mbështetja akademike konsiderohet si parashikues më i rëndësishëm në satisfaksionin e nxënësve në krahasim me shërbimet, mirëqenien, vlerësimin dhe komunikimin. Satisfaksioni i nxënësve me arsimin tregon impaktin më të rëndësishëm, ndikimin më të fortë fortë të të gjithë faktorëve të procesit edukativo arsimor. Moore (2009), Sweeney dhe Ingram (2001) e përcaktojnë satisfaksionin e nxënësve si *"Perceptimi i kënaqësisë dhe arritjes në mjedisin mësimor"*.

Institucionet arsimore përdorin metodologji të caktuara për të përcaktuar nivelin e satisfaksionit të nxënësve në lidhje me shërbimet dhe programet që ata ofrojnë për të përmbushur më mirë nevojat e nxënësve dhe plotësimin e aspiratave të tyre (Qureshi et al., 2011). Satisfaksioni është një nga emocionet themelore të reflektimit në ngjarjet shkollore. Përshtypjet emocionale gjatë procesit të mësimdhënies, rregullojnë lidhjen e nxënësve me mësimdhënien dhe shkallën e tyre të aktivitetit.

Satisfaksioni i nxënësve bazohet në vlerësimin e produkteve të tyre apo shërbimeve të shfrytëzuara dhe përmbushjen e nevojave dhe pritjeve të tyre (Athanasopoulos et al., 2001). Nëse sektori i arsimit do t'i dinte faktorët që përmirësojnë perceptimin e kënaqësisë së nxënësve, do të ishte në gjendje të ofrojë shërbime më të mira, si dhe përmirësimin e atyre ekzistuese. Për të fituar përparësi konkurruese, Petruzzellis dhe Romanazzi (2010) rekomandojnë shkollat që të nxjerrin në pah rëndësinë strategjike të vlerave shoqërore të fituara nga nxënësit kur ata t'u bashkohen atyre. Për më tepër shkollat duhet të demonstrojnë mjete me të cilat ato ofrojnë mbështetje për nxënësit në arritjet e objektivave.

Shumë studime lidhin cilësinë e shërbimit me satisfaksionin. Për të tejkaluar shkollat rivale, institucionet priren të punojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit përmes pesë

dimensioneve të saj, përkatësisht: besueshmërisë, sigurisë, ndjeshmërisë, reagimit dhe kushteve materiale (Zeithaml et al.,2009). Besueshmëria nënkupton pranimin e shërbimit ashtu siç është premtuar (Parasuraman et al.,1988). Ky dimension është kritik në sektorin e arsimit (Danish et al., 2010) ku mund të jetë një dispozitë e shpejtë veprimi korigjues kur ndodhin gabime për të rifituar besimin e nxënësve. Për pjesën e tyre, Alexandris dhe James (2002) konfirmuan se ky dimension është përcaktuesi më jetësor në cilësinë e shërbimit. Siguria tregon mirësjelljen dhe njohjen e punonjësve që çon në besimin e klientëve (Parasuraman et al., 1988). Sigurimi i njohurive të duhura dhe mbajtja e standardeve të procesit të duhur të edukimit janë të rëndësishme për nxënësit siç argumentohet nga Alves dhe Raposo (2007).

Empatia në kontekstin arsimor shikohet si vëmendje e individualizuar e nxënësve. Për ta, ndjeshmëria është e rëndësishme sepse ata kërkojnë (Nabil El-Hilali, 2015) një kujdes të përshtatur për të arritur qëllimet e tyre. Që të jetë në gjendje të ofrojë shërbime të mira për nxënësit, stafi arsimor i institucioneve duhet të jetë i gatshëm t'u shërbejë nxënësve dhe t'u ofrojë atyre shërbimet e kërkuara menjëherë, ndërsa në të njëjtën kohë duke u përpjekur për të zgjidhur ndonjë problem që mund të ndodhë aty për aty atëherë kjo mund të njihet si dimension i cilësisë së reagimit të shërbimit (Zeithaml et al. 2009). Këto tri dimensione të fundit varen shumë nga personeli, sidomos stafi udhëheqës i shkollës, prandaj aftësitë ndërpersonale dhe reagimet ndaj problemeve të klientëve përfaqësojnë bazën e kënaqësisë së perceptuar të cilësisë së shërbimeve (Danish et al. 2010). Në industri si arsimit, konsumatorët nuk janë në gjendje të gjykojnë një shërbim para përdorimit të tij (Padma, 2006). Megjithatë, dimensionin e materialeve mund të ofrojë ndihmë duke bërë këtë vlerësim.. Pritet që institucionet arsimore të shpenzojnë shumë para për përmirësimin e objekteve dhe përmirësimin e pajisjeve të klasave dhe laboratorëve. Karrige më të rehatshme, ndriçim, tavolina dhe laboratore të lëndëve të ndryshme. Faktori tjetër që ndikon në satisfaksionin e nxënësve dhe arritjen e tyre është imazhi ose kapitali i shkollës. Ky dimension është po aq i rëndësishëm sa shërbimet e organizatave.

Ivy (2001) pajtohet që kur bën një zgjedhje të shkollës , shumica e nxënësve marrin parasysh imazhin e shkollës. Për të ofruar cilësi në njohuri në mënyrë efektive, metodat e

mësimdhënies nga instruktorët, si dhe shërbimet mbështetëse, janë dy elemente kritike (Petruzzellis dhe Romanazzi, 2010). Në mënyrë që të përballen me konkurrencën , Kwek et al. (2010) theksoi se shkollat duhet të ridizajnojnë ofertat e tyre dhe programet akademike për të përfituar nga mundësitë e reja, të rruajnë vlerat akademike dhe të përmbushin pritjet e nxënësve të tyre. Hagen dhe Jordan (2008 cituar nga Arif dhe Ilias, 2011) gjetën se kënaqësia e nxënësve rritet nga niveli i programeve akademike dhe këshillave, të cilat çojnë në përmirësimin e perspektivave të karrierës dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të nxënësve.

Që nxënësit të absorbojnë me sukses njohuritë që marrin nga profesorët e tyre, së pari duhet të jenë të kënaqur me atë shkollë. Faktorët si: shërbimi i përgjithshëm, imazhi i shkollës, metodat e mësimdhënies, programet e ofruara, qasja dhe komoditeti, taksa për shkollim, si dhe pjesëmarrja dhe bashkëveprimi i vetë nxënësve me stafin e shkollës do të ndikojnë ndjeshëm në nivelin e satisfaksionit dhe plotësimin e nevojave të tyre për të mësuar (Nabil El-Hilali, Sara Al-Jaber, Lina Hussein , 2015).

2.1 Korniza konceptuale

Në bazë të literaturës së përmendur më lartë, ky studim ka identifikuar disa variabla të rëndësishme arsimore si: përshtypja e përgjithshme e shkollës, profesionalizmi i mësimdhënësve dhe interesi për lëndën e tyre, mjedisi mësimor dhe objektet në klasë ,tekstet shkollore, ndjekja e vazhdueshme e përparimit dhe vlerësimit, cilësia dhe qasja e teknologjisë informative (IT) në metodat e mësimdhënies, stafi administrativë dhe infrastruktura të cilat ndikojnë në satisfaksionin dhe plotësimin e nevojave të nxënësve me cilësinë e arsimit të ofruar nga shkollat e mesme të Komunës së Tetovës. Më poshtë prezantojmë kornizën konceptuale në lidhje me temën në fjalë:




Fig.1: Korniza konceptuale.

Duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës së mësipërme dhe në kornizën konceptuale, në kapitujt në vazhdim do të shohim satisfaksionin dhe nevojat e nxënësve për të mësuar në shkollat e mesme të Komunës së Tetovës.

KAPITULLI I TRETË

3. METODOLOGJIA

Qasja metodologjike e punës për shtruarjen dhe analizimin e temës kombinohet në zbërthimin e përmbajtjes së saj. Ky hulumtim ka karakter edhe sasior, por mbi të gjitha cilësor për të interpretuar një punim të kësaj natyre siç është tema e magistraturës. Metodologjia e hulumtimit përbëhet nga objektivat, hipotezat, popullacioni dhe mostra e hulumtimit, metodat, instrumentet, procedura e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

3.1. Hipotezat e hulumtimit

Në lidhje me tematikën në fjalë, sigurisht se mund të shtrohet një numër i madhë i hipotezave të llojeve dhe varshmërive të ndryshme. Krahas pyetësorit, objekt studimi janë këto hipoteza sipas rradhitjes:

H1: Nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Tetovës janë të kënaqur me cilësinë e shërbimeve arsimore.

H2: Përshtypja e përgjithshme e shkollës ndikon në satisfaksionin e nxënësve për të mësuar.

H3: Nxënësit janë të kënaqur me profesionalizmin e mësimdhënësve.

H4: Nxënësit janë të kënaqur me mjedisin mësimor dhe pajisjet në klasë.

H5: Tekstet shkollore janë të dobishme dhe relevante me lëndën e dhenë.

H6: Raportet dhe bashkëveprimet e nxënësve me profesorët dhe stafin mbështetës të shkollës ka ndikim pozitiv në nivelin e satisfaksionit.

H7: Profesorët nuk bëjnë dallim gjatë vlerësimit të nxënësve.

H8: Satisfaksioni nga reputacioni i shkollës ndikon në arritjen e suksesit në shkollë.

3.2. Metodatat, teknikat dhe procedurat e zbatuara

Për realizimin e këtij hulumtimi, do të përdoren këto metoda:

- Metoda empirike – kjo metodë kryesisht do të përdoret për të identifikuar aspektet kuantitative të gjendjes faktike në lidhje me çështjen në fjalë.
- Metodatat statistike – kryesisht do të përdoren për grupimin dhe manipulimin me të dhënat e grumbulluara gjatë këtij hulumtimi. Për këtë qëllim do të përdoret softëri-in statistik SPSS (Statistical Package for the Social Sciences) për analizën e rezultateve, vërtetësinë e hipotezës të parashtruar si dhe sjelljen e konkluzioneve të nevojshme.
- Metoda e induksionit dhe e deduksionit – kjo metodë kryesisht do të përdoret për sjelljen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve në lidhje me temën e shtruar. Gjithnjë duke filluar prej të dhënave të grumbulluara, analizën e faktorëve signifikantë si dhe varësinë në mes variablave të ndryshme.
- Metoda komparative – do të shfrytëzohet për të gjitha krahasimet e nevojshme për këtë hulumtim.
- Metoda analitike - do të përdoret për analizën e rezultateve të fituara si dhe sjelljen e konkluzioneve dhe rekomandimeve në bazë të atyre rezultateve.

3.3. Instrumentet e hulumtimit

Ky është një studim transversal ku si instrument për mbledhjen e të dhënave kemi përdorur pyetësor për nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Tetovës, me pyetje

të standardizuara në lidhje me këtë punim. Me anë të metodës sasiore të grumbullimit të të dhënave, respektivisht grumbullimit të të dhënave nga përgjigjet e fituara prej pyetsorit të përpiluar enkas për këtë qëllim, përshkruhet dhe analizohet satisfaksioni dhe nevojat e nxënësve për të mësuar për rastin në fjalë.

Pyetëtori përbëhet nga gjashtë paragrafe:

- PARAGRAFI I - Të dhënat demografike me gjithsej 8 pyetje.
- PARAGRAFI II - Cilësia e bashkëveprimeve me të gjithë punonjësit e shkollës me gjithsej 10 pyetje.
- PARAGRAFI III - Cilësia e mjedisit mësimor në shkollë me gjithsej 11 pyetje.
- PARAGRAFI IV - Eksperienca mësimore në shkollë me gjithsej 8 pyetje.
- PARAGRAFI V - Vlerësimi i nxënësve dhe vetvlerësimi me gjithsej 5 pyetje.
- PARAGRAFI VI - Vlerësimi në lidhje me ndikimin e faktorëve tjerë relevant me ndikim, me gjithsej 6 pyetje.

3.4. Popullimi i studimit dhe format e analizës së të dhënave

Popullimi i këtij studimi përbëhet nga nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Tetovës. Gjatë këtij hulumtimi janë anketuar, respektivisht kemi përdorur një mostër prej 195 nxënësve të shtatë shkollave të mesme të Komunës së Tetovës dhe një shkolle fillore, me këtë shpërndarje:

Tabela 1: Shpërndarja e nxënësve në bazë të shkollës në të cilën ndjekin mësimin.

Emri i shkollës	Numri i të anketuarve
-----------------	-----------------------

SHMK Gjinnazi i Tetovës “ Kiril Pejcinoviq”	39
SHMK Gjinnazi i Dytë “ 7 Marsi “ – Tetovë	25
SHMKM “ Nikolla Shtejn “ – Tetovë	41
SHME “ 8 Shtatori” – Tetovë	33
SHMPK “ Mosha Pijade” – Tetovë	11
SHMPK “Gjoce Stojçeski” – Tetovë	13
Shkolla e muzikës “ Todor Skallovski – Tetoec	8
Shfk “Bratstvo-Migjeni”- Tetovë	25

Sipas shkollës në të cilën mësojnë, vijon se 39.3% prej tyre janë meshkuj kurse 60.2% janë femra. Pyetësorët u shpërndanë në mënyrë të përshtatshme, ku paraprakisht u morrë leje nga drejtorja e shkollës duke shpjeguar arsyet dhe qëllimin e tij. Udhëzimet e duhura janë shkruar në pyetësor në mënyrë që të plotësohet si duhet. Janë shfrytëzuar pyetje të kategorive të ndryshme prej formës kuantitative deri në pyetje të shkallës së LIKERTIT edhe ato prej shkallës 1 (plotësisht nuk pajtohem) deri në shkallën e 5 (plotësisht pajtohem). Mesatarja e matur statistikisht është përdorur për t’iu përgjigjur pyetjeve të hulumtimit. Opcionet e përgjigjes në instrument vlerësohen si më poshtë:

Tabela 2: Vlerësimi në bazë të shkallës së Likertit.

Plotësisht nuk pajtohem	Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem	Plotësisht pajtohem
1 pikë	2 pikë	3 pikë	4 pikë	5 pikë

Pika e pranimit është 3.00 dhe çdo mesatare më e ulët se 3.00 konsiderohet e refuzuar.

Për analizën e rezultateve është shfrytëzuar softueri statistikor SPSS. Eshtë bërë analizë deskriptive e variablave të ndryshme, analiza e frekuencave të shoqëruara me paraqitje dhe reprezentime grafike të faktorëve, por poashtu kemi shfrytëzuar analizat e statistikës inferenciale për analizën e varshmërisë në mes faktorëve të ndryshëm. Duke shfrytëzuar Chi-square testin

nëpërmjet koeficientit të Pirsonit, kjo mundësoi vërtetimin e hipotezave të parashtruara varësisht nga ajo se, për vlerë të fituar më të vogël se vlera referente që është 0.05 (5%) hipoteza plotësohet. Respektivisht, kjo tregon një varshmëri signifikante në mes variablave, në të kundërtën, nëse vlera e fituar është më e madhe se vlera referente 0.05 atëherë themi se hipoteza nuk përmbushet dhe mund të përfundohet se variablat janë të pavarura në mes veti. Poashtu kemi shfrytëzuar edhe analizën e korelacionit në mes faktorëve të ndryshëm edhe atë korelacioni i tipit "*Bivariate*", për shkak se analizën e bëjmë për korelacionin ndërmjet variablave në çifte. Nëse vlera signifikante është më e vogël se 0.05 atëherë korelacioni ekziston. Me këtë rast vlera e koeficientit të korelacionit të Pirsonit mund të jetë ndërmjet -1 dhe 1. Nëse ajo vlerë është 0, do të thotë se korelacion linear në mes variablave nuk ekziston. Sa më afër vlerës 1 aq më i fortë është korelacioni linear i drejtë. Do të thotë se me rritjen e vlerave të njërës variabël rriten edhe vlerat e variablës tjetër. Sa më afër vlerës -1 aq më i fortë është korelacioni linear i zhdrejtë, do të thotë me rritjen e vlerave të njërës variabël, vlerat e variablës tjetër zvogëlohen.

Kemi bërë analizën e regresionit linear. Është shfrytëzuar regresioni i shumëfishtë ku kemi marrë një variabël si variabël e varur, ndërsa disa variabla tjera si të pavarura me qëllim që të shohim shkallën e varshmërisë lineare të variablës së varur që është objekt i analizës sonë. Edhe këtu kemi shfrytëzuar kushtin që regresioni linear është signifikant nëse vlera është më e vogël se 0.05.

KAPITULLI I KATËRT

4. REZULTATET E STUDIMIT

Siç e cekëm edhe më lartë, në këtë studim kanë marrë pjesë gjithësej 196 nxënës, të shpërndarë sipas gjinisë me 39.3 % meshkuj dhe 60.2 % femra, në mënyrë të rastësishme. Prej tyre 13.3 % ndjekin mësimin në klasën e nëntë, 18.4% në vitin e parë, 15.8% në vitin e dytë, 34.2% në vitin e tretë dhe 18.4% në vitin e fundit të shkollës së mesme. Në figurën e mëposhtme (fig.1) do të japim edhe një paraqitje grafike të shpërndarjes së nxënësve sipas gjinisë dhe vitit në të cilin ndjekin mësimin:




Fig.2: Shpërndarja e nxënësve sipas gjinisë dhe vitit në të cilin ndjekin shkollimin.

Në lidhje me suksesin e nxënësit të treguar në vitin paraprak, 8.2% e të anketuarve janë me sukses të mjaftueshëm, 28.6 % me mirë, 31.6 % me shumë mirë dhe poashtu 31.6 % me shëllyeshëm. Për sa i përket pyetjes së venbanimit të tyre , 52% e nxënësve vijnë nga fshati kurse 48% nga qyteti.

Më poshtë japim grafikonet e këtyre disperzioneve:




Fig.3 Shpërndarja sipas suksesit dhe venbanimit

Në pyetjen se “A ndikon reputacioni (përshtypja e përgjithshme) i shkollës në satisfaksionin tuaj për të mësuar” , 40.8% e nxënësve mendojnë se po, 19.9% mendojnë se jo , kurse 31.1% nuk e dijnë. Nga ky rezultat, konkludojmë se një përqindje e konsiderueshme e nxënësve janë të mendimit se reputacioni i shkollës, d.t.th. mendimi se i përket një shkolle elitare krijon satisfaksion gjatë të mësuarit.

Shpërndarja grafike duket si më poshtë:




Fig.4: Opinioni i ndikimit të reputacionit të shkollës në satisfaksionin e të mësuarit.

Në lidhje me pyetjen se “ Nëse do të mundej të ktheheshit prapa në kohë, a do të kishit zgjedhur përsëri shkollën në të cilën mësoni”, kemi këtë shpërndarje: 73.5% do të kishin zgjedhur përsëri shkollën në të cilën mësojnë , 12.2 % nuk do të kishin zgjedhur përsëri të mësonin në të njëjtën shkollë, kurse 13.3 nuk e dijnë . Në lidhje me pyetjen e rradhës se a do t’ua kishin rekomanduar shkollën në të cilën ndjekin mësimin ndonjë miku apo familjari, 76.5% e nxënësve janë përgjigjur se po, 13.8% jo dhe vetëm 8.7% nuk e dijnë. Shperndarjet e tilla nëpërmjet grafikoneve duken si më poshtë:




Fig. 5 : Shpërndarja e ripërzgjedhjes së shkollës dhe rekomandimit.

4.1. Cilësia e bashkëveprimeve me të gjithë punonjësit e shkollës

Në grafikonet e mëposhtme, nga fig.6 deri në fig.15, shihet niveli i satisfaksionit dhe nevojave të nxënësve në lidhje me cilësinë e bashkëveprimeve me të gjithë punonjësit e shkollës. Siç e cekëm edhe më sipër, përgjigjet janë ndarë në pesë kategori të ndryshme duke u nisur nga niveli 1 (plotësisht nuk pajtohem) dhe përfundon me nivelin e 5 (plotësisht pajtohem) që nënkupton atë se nxënësit janë plotësisht të kënaqur me variablën në fjalë.




Fig.6: Satisfaksioni i nxënësve me njohuritë e gjëra të profesorëve në lëndën përkatëse.




Fig.7: Satisfaksioni i nxënësve se a kanë profesorët aftësi të mira mësimore.




Fig.8: Satisfaksioni i nxënësve me sjelljen e profesorëve dhe stafit mbështetës të shkollës.




Fig.9: Satisfaksioni i nxënësve në lidhje me komunikimin dhe afërsinë.




Fig.10: Satisfaksioni i nxënësve në lidhje me pjesëmarrjen e diskutimeve në klasë.




Fig.11: Niveli i satisfaksionit të nxënësve me mjedisin, organizimin në klasë.




Fig.12: Satisfaksioni i nxënësve me profesorët dhe stafin mbështetës të shkollës, për sa i përket shqetësimit të tyre mbi mirëqenien dhe interesat e nxënësve.

P.8. Profesorët dhe stafi mbështetës i shkollës janë të gatshëm të ndihmojnë në shqetësimet e nxënësve




Fig.13 : Niveli i kënaqësisë së nxënësve mbi ndihmën e ofruar nga profesorët dhe stafi udhëheqës në rast të ndonjë shqetësimi.

P.9. Staf i administratës së shkollës është i sjellshëm, ju siguron ndihmë nxënësve dhe i zgjidh problemet në një kohë të premtuar




Fig.14: Satisfaksioni i nxënësve me stafin udhëheqës të shkollës në lidhje me sigurimin e ndihmës dhe zgjidhjes së problemeve në kohë të premtuar.

P.10. Në përgjithësi, cilësia e ndërveprimeve me të gjithë punonjësit e përfshirë në këtë shkollë është e shkëlqyeshme




Fig.15: Niveli i satisfaksionit të nxënësve në përgjithësi me cilësinë e bashkëveprimeve me të gjithë punonjësit e përfshirë në shkollë.

Nga rezultatet e fituara kemi këto përfundime:

i: Në lidhje me atë se profesorët kanë njohuri të gjëra në lëndën e tyre (fig. 6), 43.9 % e të anketuarve kanë dhënë vlerësim maksimal 5 në bazë të shkallës së Likertit , 35.7% kanë dhënë vlerësim 4, 11.2% vlerësim 3 , 3.6% vlerësim 2 dhe vetëm 5.6% e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur me njohuritë e profesorëve në lëndën përkatëse. Ky rezultat tregon se nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Tetovës janë të kënaqur me ekspertizën e mësimdhënësve të tyre.

ii: Në fig.7 shohim se 44.9% e nxënësve janë plotësisht të kënaqur me aftësitë mësimore të mësimdhënësve të tyre duke dhënë vlerësim maksimal 5, 36.2% kanë dhënë vlerësim 4, 11.7% kanë dhënë vlerësim 3, 4.6 % kanë dhënë vlerësim 2, kurse vetëm 2% e nxënësve janë plotësisht të pakënaqur duke vlerësuar me 1 aftësitë mësimore të mësimdhënësve, që paraqet një përqindje relativisht të ulët e cila mund të mos përfilllet.

iii: Në lidhje me atë se profesorët dhe stafi mbështetës janë të sjellshëm (fig. 8), 50% e të anketuarve janë plotësisht të kënaqur me këtë aspekt dhe kanë dhënë vlerësim maksimal 5, 21.9% kanë dhënë vlerësim 4, 19.9% kanë dhënë vlerësim 3, 3.6% kanë dhënë vlerësim 2 kurse vetëm 4.1% e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur me sjelljen e profesorëve dhe stafit mbështetës duke vlerësuar me 1. Pra, edhe këtu dominon ajo se nxënësit janë plotësisht të kënaqur me sjelljen e profesorëve dhe stafit mbështetës.

iv: Në lidhje me atë se nxënësit ndihen rehat duke u afruar dhe duke biseduar me profesorët (fig. 9), 42.9 % e të anketuarve kanë dhënë vlerësim maksimal 5 (plotësisht të kënaqur), 28.1% kanë dhënë vlerësim 4, 13.3% vlerësim 3, 7.1 % vlerësim 2 dhe vetëm 5.6% e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur në lidhje me këtë variabël duke dhënë vlerësim minimal.

v: Në fig.10 , për sa i përket asaj se nxënësi ka mundësinë të merr pjesë në diskutimet në klasë, një përqindje e madhe prej 60.7 % jep vlerësim maksimal me 5 dhe kjo bën të nënkuptojmë që nxënësit e kohës së sodit kanë liri në të shprehurit e mendimit të lirë, gjë e cila çon në fleksibilitet. Nga grafikoni shohim që 20.9% e nxënësve kanë dhënë vlerësim 4, 7.1% kanë dhënë vlerësim 3, 6.6 % kanë dhënë vlerësim 2 dhe 4.1% kanë dhënë vlerësim minimal 1 për të shprehur pakënaqësinë.

vi: Për sa i përket organizimit, përgatitjes dhe komoditetit nëpër klasa (fig. 11) ,vetëm 28.6% e të anketuarve janë plotësisht të kënaqur me këtë aspekt dhe kanë dhënë vlerësim maksimal 5, kurse dominon vlerësimi me 4 prej 32.7% , 16.3% kanë dhënë vlerësim 3, 9.7% kanë dhënë vlerësim 2 dhe 10.2 % e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur duke vlerësuar me 1.

vii: Në lidhje mbi shqetësimin për mirëqenien dhe interesave të nxënësve nga ana e profesorëve dhe stafit mbështetës të shkollës (fig.12), vetëm 21.9 % e nxënësve dhanë një vlerësim prej 5 pikësh, për të dominuar më pastaj vlerësimi me 4 pikë me një përqindje prej 31.1 %, 23 % dhanë vlerësim 3 pikësh, 12.8 % dhanë vlerësim 2 pikësh dhe vetëm 7.1 % e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur në lidhje me këtë variabël duke dhënë vlerësim minimal prej 1 pikësh.

viii: Në fig.13, për sa i përket asaj se profesorët dhe stafi mbështetës janë të gatshëm të ndihmojnë në shqetësimet e nxënësve, një përqindje e madhe prej 44.9 % jep vlerësim maksimal me 5, qe tregon se një numër i konsiderueshëm nxënësish janë plotësisht të kënaqur nga ky faktor. Nga grafikoni shohim që vlerësim minimal prej një pikësh, për të shprehur plotësisht pakënaqësinë është një grup i vogël prej 8.2%.

ix: Duke analizuar fig.14, rezulton ajo se në lidhje me sigurimin e ndihmës në kohë të premtuar, 29.1% e të anketuarve janë plotësisht të kënaqur me këtë aspekt dhe kanë dhënë vlerësim maksimal 5, kurse pason vlerësimi me 4 pikësh prej 30.1 %, 18.4% kanë dhënë vlerësim 3, 11.7% kanë dhënë vlerësim 2 dhe 9.2 % e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur duke vlerësuar me 1.

x: Në lidhje me atë se cilësia e bashkëpunimit me të gjithë punonjësit e shkollës është e shkëlqyeshme (fig.15), nxënësit mesatarisht janë të kënaqur në këtë aspekt sepse 32.1% kanë dhënë vlerësim prej 5 pikësh, 29.6% kanë vlerësuar me 4 pikë, 23.5 me 3 pikë, 7.7% me 2 pikë dhe 5.6 me vlerësim minimal prej 1 pikësh.

Në vazhdim japim edhe tabelën e rezultateve deskriptive në lidhje me mesataret e fituara të këtyre dhjetë variablave, ku kënaqësi më të madhe nxënësit shprehin në pjesëmarrjen e diskutimeve në klasë për të treguar atë që ndiejnë dhe mendojnë me një vlerësim prej 4.28.

Tabela 3: Të dhënat nga statistika deskriptive për cilësinë e bashkëveprimeve me të gjithë punonjësit e shkollës.

	P.1	P.2	P.3	P.4	P.5	P.6	P.7	P.8	P.9	P.10
N	196	195	195	196	195	191	188	193	193	193
V	0	1	1	0	1	5	8	3	3	3
M	4.09	4.18	4.11	3.95	4.28	3.61	3.50	3.88	3.59	3.76
Mean	4.00	4.00	5.00	4.00	5.00	4.00	4.00	4.00	4.00	4.00
Median	5	5	5	5	5	4	4	5	4	5
Mode	1.094	.954	1.100	1.178	1.116	1.288	1.195	1.296	1.280	1.157
Std. Deviation	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Minimum	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5
Maximum										

4.2 . Cilësia e mjedisit mësimor në klasë

Në pjesën në vazhdim, në grafikonet nga fig.16 deri në fig.26, do të shohim satisfaksionin dhe nevojat e nxënësve në lidhje me cilësinë e mjedisit mësimor në shkollë me gjithësej 11 variabla.




Fig.16: Niveli i satisfaksionit me materialet e lëndëve (teksteve shkollore).




Fig.17: Satisfaksioni në lidhje me atë se materialet e lëndëve janë relevante me lëndën e dhënë.




Fig.18 : Përputhshmëria e materijaleve mësimorë me interesat e nxënësve.




Fig.19: Satisfaksioni i nxënësve me koleksionin e librave në bibliotekën e shkollës.




Fig.20: Satisfaksioni i nxënësve me stafin e bibliotekës gjatë ofrimit të librave.

P.6. Laboratorët kompjuterikë kanë pajisje cilësore (p.sh hardware,software).




Fig.21: Satisfaksioni i nxënësve me pajisjet cilësore të laboratorëve kompjuterikë.

P.7. Klasat në të cilat kryhet procesi mësimor janë komforte dhe kanë pajisje cilësore.




Fig.22: Satisfaksioni i nxënësve në lidhje me atë se, klasat në të cilat ktyhet procesi mësimor janë komforte dhe kanë pajisje cilësore.




Fig.23 : Satisfaksioni i nxënësve në lidhje me atë se salla dhe fusha sportive posedojnë kushte bashkëkohore.




Fig.24: Satisfaksioni i nxënësve në lidhje me atë se hapsirat e shkollës janë të pastërta.




Fig.25: Niveli i satisfaksionit të nxënësve në lidhje me atë se hapësirat e jashtme të shkollës janë të pastërta.




Fig.26: Satisfaksioni i nxënësve se në përgjithësi, cilësia e mjedisit mësimor në shkollë është e shkëlqyeshme.

Tabela e rezultateve deskriptive në lidhje me mesataret e fituara të këtyre njëmbëdhjetë variablave është si në vijim:

Tabela 4: Të dhënat nga statistika deskriptive për cilësinë e mjedisit mësimor në shkollë.

		P.1	P.2	P.3	P.4	P.5	P.6	P.7	P.8	P.9	P.10	P.11
N	V	194	192	191	195	194	195	188	196	196	196	177
	M	2	4	5	1	2	1	8	0	0	0	19
Mean		3.81	3.88	3.73	2.79	3.18	3.46	3.23	3.39	3.59	3.68	3.71
Median		4.00	4.00	4.00	3.00	3.00	4.00	3.00	4.00	4.00	4.00	4.00
Mode		5	4	4	1	5	5	4	5	5	5	5
Std. Deviation		1.203	1.109	1.133	1.493	1.521	1.486	1.306	1.462	1.424	1.313	1.212
Minimum		1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Maximum		5	5	5	5	5	6	5	5	5	5	5

Nga rezultatet e fituara kemi këto përfundime:

i: Për sa i përket asaj se materialet e lëndëve (p.sh tekstet shkollore, doracakët) janë të dobishme, (fig. 16), 36.7% e të anketuarve kanë dhënë vlerësim maksimal 5 (plotësisht të kënaqur) në bazë të shkallës së Likertit , 29.1% kanë dhënë vlerësim 4, 16.3% vlerësim 3 , 11.7 % vlerësim 2 dhe vetëm 5.1 % e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur. Ky rezultat tregon se nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Tetovës janë të kënaqur me materialet e lëndëve.

ii: Në fig.17 shohim se 32.7 % e nxënësve janë plotësisht të kënaqur me atë se materialet e lëndëve janë relevante me lëndën e caktuar duke dhënë vlerësim maksimal 5, 36.2% kanë dhënë vlerësim 4, 19.4% kanë dhënë vlerësim 3, 3.6 % kanë dhënë vlerësim 2 kurse vetëm 6.1 % e nxënësve janë plotësisht të pakënaqur duke vlerësuar me 1.

iii: Në lidhje me atë se materialet e lëndëve janë në përputhje me interesat e nxënësve (fig.18), vetëm 28.6 % e të anketuarve janë plotësisht të kënaqur në këtë aspekt dhe kanë dhënë vlerësim maksimal 5, 32.7 % kanë dhënë vlerësim 4, 22.4 % kanë dhënë vlerësim 3, 8.7 % kanë dhënë vlerësim 2 kurse vetëm 4.1% e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur me atë se materialet e lëndëve janë në përputhje me interesat e nxënësve duke dhënë vlerësim minimal 1. Pra, këtu dominon ajo se nxënësit janë të kënaqur me variablën në fjalë.

iv: Për sa i përket asaj se biblioteka e shkollës ka një koleksion të gjërë librash në dispozicion, (fig. 19), një përqindje jo e konsiderueshme prej 17.9 % ka dhënë vlerësim maksimal 5 (plotësisht të kënaqur). Poashtu, 17.9 % kanë dhënë vlerësim 4, 19.9 % vlerësim 3, 13.3 % vlerësim 2 kurse me një përqindje dominuese prej 30.6% e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur për sa i përket mobilizimit të bibliotekës së shkollës. Për sa i përket kësaj variable, një mesatare prej 2.79 në bazë vlerësimit të nxënësve rezulton ajo që nxënësit nuk janë të kënaqur me koleksionimin e bibliotekës së shkollës.

v: Në fig.20, për sa i përket asaj se stafi i bibliotekës ofron informata kthyesë kur kërkohet, një përqindje prej 27.6 % jep vlerësim maksimal me 5. Poashtu nga grafikoni shohim që, 19.9% e nxënësve kanë dhënë vlerësim 4, 16.3 % kanë dhënë vlerësim 3, 13.3 % kanë dhënë vlerësim 2 dhe një përqindje e konsiderueshme prej 21.9 % kanë dhënë vlerësim minimal 1 për të shprehur pakënaqësinë e plotë në lidhje me këtë aspekt. Do të thotë që edhe kjo variabël me një mesatare minimale prej 3.18 plotëson disi satisfaksionin dhe nevojat e nxënësve.

vi: Në lidhje me atë se laboratorët kompjuterikë kanë pajisje cilësore (fig. 21), 33.2 % e të anketuarve janë plotësisht të kënaqur dhe kanë dhënë vlerësim maksimal 5, kurse vlerësim me 4 pikë kanë dhënë 24 %, 12.2 % kanë dhënë vlerësim 3, 13.3 % kanë dhënë vlerësim 2 dhe 16.3% e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur duke vlerësuar me 1. Pra, nga ky rezultat që duket mjaft variabil konkludojmë që nxënësit mbajnë qëndrim neutral në lidhje me pajisjen e laboratorëve kompjuterikë, meqë vlerësimi mesatar del 3.00 në një shkallë prej 1 deri në 5.

vii: Një ndër variablat kryesore që paraqet satisfaksion dhe plotësim nevoje të nxënësit për të mësuar është ajo se, klasat në të cilat kryhet procesi mësimor a janë konforte dhe a kanë pajisje cilësore ,fig. 22. Në lidhje me këtë aspekt, 18.9 % e nxënësve dhanë një vlerësim prej 5 pikësh ,

për të dominuar më pastaj vlerësimi me 4 pikë me një përqindje prej 26 % , 21.4 % dhanë vlerësim 3 pikësh , 17.3 % dhanë vlerësim 2 pikësh dhe vetëm 12.2 % e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur në lidhje me këtë variabël duke dhënë vlerësim minimal prej 1 pikësh. Mesatarja në bazë të këtyre statistikave është 3.23.

viii: Në fig.23, për sa i përket asaj se salla dhe fusha sportive posedojnë kushte bashkëkohore, një fenomen po aq i rëndësishëm për nxënësit , 30.6 % i japin vlerësim maksimal me 5 poena për të shprehur satisfaksionin e plotë. 17.3 % japin vlerësim prej 4 pikësh, për të pasuar më pastaj 2 pikëshi me 10.2%. Nga grafikoni shohim që vlerësim minimal prej 1 pikësh, për të shprehur plotësisht pakënaqësinë është një grup i konsiderueshëm prej 17.9 %. Për ta përmbyllur vlerësimin e kësaj variable, dukë marrë për bazë tabelën 2, nxënësit janë disi të kënaqur me kushtet në sallën dhe fushën e sportit me një mesatare prej 3.39 pikëshe.

ix: Duke analizuar fig.24, në lidhje me atë se hapsirat e shkollës janë të pastërta, një përqindje e konsiderueshme prej 38.3 % e të anketuarve janë plotësisht të kënaqur me këtë aspekt duke dhënë vlerësim maksimal prej 5 pikësh , kurse mëpastaj pason vlerësimi me 4 pikësh prej 20.4% , 16.3% kanë dhënë vlerësim 3, 12.2% kanë dhënë vlerësim 2 dhe dhe ngjajshmërisht 12.8 % janë plotësisht të pakënaqur duke vlerësuar me 1. Në kuadër të këtyre statistikave, 3.59 është mesatarja e satisfaksionit në lidhje me këtë variabël që çon në konkluzion se nxënësit janë të kënaqur me pastërtinë në shkollë.

x: Për sa i përket asaj se hapësirat e jashtme të shkollës janë të pastërta (fig.25), nxënësit janë të kënaqur në këtë aspekt sepse mesatarja dukë u bazuar në tabelën 2 është e barabartë me 3.68.

xi: Në fig.26, që përshkruan në mënyrë grafike variablën se, në përgjithësi cilësia e mjedisit mësimor në shkollë është e shkëlqyeshme , një numër i konsiderueshëm i të anketuarve prej 36.2% janë plotësisht të kënaqur duke vlerësuar me 5 pikë këtë cilësi kurse vetëm 9.2 % janë plotësisht të pakënaqur. Mesatarja në lidhje me këtë aspekt, në bazë të tabelës 2 është 3.71 (vlerësimi më i lartë deri tani) dhe jep përfundimin që nxënësit janë të kënaqur me cilësinë e mjedisit mësimor në shkollë edhe pse jo plotësisht të kënaqur (niveli 5 pikësh).

Në lidhje me pyetjen e drejtpërdrejtë për nivelin e mjedisit të shkollës është interesant se mesatarja është 3.71, pra dominon përshtypja se nxënësit janë të kënaqur. Këtij konkluzioni i bashkangjesim edhe vlerën e modës që është 5, që do të thotë se numri më i madhë i nxënësve janë përgjigjur me vlerësim maksimal për mjedisin. Kjo në njëfarë mënyre e vërteton hipotezën 4. Konkluzionit të mësipërm i bashkangjesim tabelën e mëposhtme.

Tabela 5: Të dhënat statistikore mbi modën dhe mesataren e e variablës mbi nivelin e mjedisit të shkollës.

N	Valid	177
	Missing	21
Mean		3.71
Mode		5

4.3 Eksperienca mësimore në shkollë

Në sektorin në vazhdim, duke filluar nga fig. 27-34, do të shohim satisfaksionin e nxënësve me eksperiencën mësimore në shkollë nëpërmjet grafikoneve si dhe statistikat deskriptive të variablave të këtij sektori.

P.1. Gjatë ndjekjes së procesit edukativo-arsimor, kam fituar njohuri të përgjithëshme në fusha të ndryshme.




Fig.27: Niveli i satisfaksionit të nxënësve se gjatë ndjekjes së procesit edukativo-arsimor kanë fituar njohuri të përgjithëshme në fusha të ndryshme.

P.2. Kam zhvilluar mendimin tim analitik dhe logjik.




Fig.28 : Niveli i satisfaksionit të nxënësve se kanë zhvilluar mendimin analitik dhe logjik.




Fig.29: Niveli i satisfaksionit të nxënësve se kanë zhvilluar aftësitë e shkrimit dhe të folurit.




Fig.30: Niveli i satisfaksionit të nxënësve se kanë zhvilluar një kod personal të vlerave dhe etikës (moralit).

P.5. Unë kam përmirësuar aftësitë e mia për të mësuar në mënyrë efektive , për të ndjekur idetë dhe për të gjetur informacionin që kam nevojë.




Fig.31: Niveli i satisfaksionit të nxënësve në përmirësimin e aftësive për të mësuar në mënyrë efektive, për të ndjekur idetë dhe për të gjetur informacionin që kanë nevojë.

P.6. Unë kam zhvilluar aftësinë për të funksionuar si një anëtar ekipi.




Fig.32: Satisfaksioni i nxënësve për zhvillimin e aftësive në funksionimin si një anëtar ekipi.




Fig.33: Satisfaksioni i nxënësve mbi suksesin e pritur.




Fig.34: Niveli i satisfaksionit të nxënësve mbi eksperiencën në shkollë.

Tabela e rezultateve deskriptive në lidhje me mesataret e fituara të këtyre njëmbëdhjetë variablave është si në vijim:

Tabela 6: Të dhënat nga statistika deskriptive për eksperiencën mësimore në shkollë.

	P.1	P.2	P.3	P.4	P.5	P.6	P.7	P.8
N Valid	195	195	196	195	194	195	196	194
Missing	1	1	0	1	2	1	0	2
Mean	4.03	4.16	4.37	4.46	4.38	4.05	4.07	3.97
Median	4.00	4.00	5.00	5.00	5.00	4.00	4.00	4.00
Mode	5	5	5	5	5	5	5	5
Std. Deviation	1.062	.933	.932	.920	.880	1.109	1.008	1.082
Minimum	1	1	1	1	1	1	1	1
Maximum	5	5	5	5	5	5	5	5

Nga rezultatet e mësipërme kemi këto përfundime:

i: Në lidhje me atë se, gjatë ndjekjes së procesit edukativo-arsimor, kam fituar njohuri të përgjithshme në fusha të ndryshme (fig 27), 41.3% e të anketuarve shprehin satisfaksion të plotë në këtë aspekt duke e vlerësuar me 5 pikë të shkallës së Likertit, 31.6 % kanë dhënë vlerësim 4, 17.9 % vlerësim 3, 5.1 % vlerësim 2 dhe vetëm 3.6 % e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur duke vlerësuar me 1. Ky rezultat në përqindje dhe bazimi në tabelën 4 me një mesatare të llogaritur prej 4.03, konkludon në atë se nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Tetovës janë të kënaqur me njohuritë e përgjithëshme që kanë fituar në fusha të ndryshme.

ii : Në fig.28, shohim se 41.3 % e nxënësve janë plotësisht të kënaqur me atë se kanë arritur të zhvillojnë mendimin analitik dhe logjik duke dhënë vlerësim maksimal 5, 37.2% kanë dhënë vlerësim 4, 14.8 % kanë dhënë vlerësim 3, 2.0 % kanë dhënë vlerësim 2 kurse vetëm 2.6 % e nxënësve janë plotësisht të pakënaqur duke vlerësuar me 1 këtë variabël. Në bazë të këtij vlerësimi dhe tabelës 4, me një mesatare prej 4.16 pikëshe nxënësit konfirmojnë se janë të kënaqur në zhvillimin e të menduarit analitik dhe logjik.

iii: Në lidhje me variablën se kam zhvilluar aftësitë e shkrimit dhe të të folurit (fig.29) , një përqindje goxha e konsiderueshme prej 59.7 % e të anketuarve janë plotësisht të kënaqur në këtë aspekt dhe kanë dhënë vlerësim maksimal 5, poashtu 24.5 % kanë dhënë vlerësim 4, 10.2% kanë dhënë vlerësim 3, 4.1 % kanë dhënë vlerësim 2, kurse vetëm 1.5 % e të anketuarve janë plotësisht të pakënaqur duke dhënë vlerësim minimal 1. Pra, këtu dominon ajo se me një mesatare prej 4.37 pikëshe, nxënësit janë të kënaqur me aftësitë e të shkruarit dhe të folurit.

iv: Për sa i përket asaj se kam zhvilluar një kod personal të vlerave dhe etikës (moralit), fig.30, 66.3 % kanë dhënë vlerësim 5 pikësh duke shprehur plotësisht satisfaksionin në lidhje me këtë aspekt, kurse 19.4 % kanë dhënë vlerësim 4, 8.2 % vlerësim 3, 4.1 % vlerësim 2 kurse me një përqindje jashtëzakonisht të vogël prej 1.5 % e të anketuarve shprehet pakënaqësia duke dhënë vlerësim minimal. Atëherë, në bazë të kësaj përqindjeje më lartë dhe tabelës 4, me një mesatare prej 4.37 pikëshe shprehet ajo se nxënësit janë të kënaqur se kanë zhvilluar një kod personal të vlerave dhe etikës.

v: Në fig.31, duke shprehur grafikisht atë se nxënësi ka përmirësuar aftësitë për të mësuar në mënyrë efektive, për të ndjekur idetë dhe për të gjetur informacionin për të cilin ka nevojë, shihet se 57.1% e nxënësve janë plotësisht të kënaqur se i posedojnë këto vlera duke rrethuar numrin 5. Poashtu, nga grafikoni shohim që 28.1 % e nxënësve janë të kënaqur me këtë duke dhënë vlerësim 4 pikësh , 8.2 % kanë dhënë vlerësim 3, 5.1 % kanë dhënë vlerësim 2 dhe një përqindje e vogël prej 5% kanë dhënë vlerësim minimal 1 për të shprehur pakënaqësinë e plotë në lidhje me këtë aspekt. Si përfundim dominon ajo se, nxënësit janë të kënaqur me këtë variabël me një mesatare të konsiderueshme prej 4.38 pikëshe.

vi: Në lidhje me atë se nxënësi ka zhvilluar aftësinë për të funksionuar si një anëtarë ekipi, (fig.32), 45.9 % e të anketuarve janë plotësisht të kënaqur dhe besojnë se mund të funksionojnë si anëtarë ekipi, 25.5 % janë të kënaqur duke rrethuar 4 pikëshin, 19 % kanë dhënë vlerësim 3, 5.1 % e të anketuarve janë të pakënaqur duke vlerësuar me 2 dhe 4.1% janë plotësisht të

pakënaqur dhe besojnë se nuk kanë zhvilluar aftësi për të funksionuar si një anëtar ekipi. Pra, me një mesatare prej 4.05 pikëshe nxënësit shprehin kënaqësinë me variablën në fjalë.

vii: Një ndër variablat kryesore që paraqet satisfaksion dhe plotësim nevoje të nxënësit për të mësuar është mendimi se nxënësi ka arritur suksesin e pritur (fig. 33). Në lidhje me këtë aspekt, 42.3 % e nxënësve dhanë një vlerësim prej 5 pikësh , për të pasuar mëpastaj vlerësimi me 4 pikë prej 26 % e të anketuarve, 31.6 % dhanë vlerësim 3 pikësh , 20.9 % dhanë vlerësim 2 pikësh dhe vetëm 2% janë plotësisht të pakënaqur në lidhje me këtë variabël duke dhënë vlerësim minimal prej 1 pikësh. Mesatarja në bazë të këtyre statistikave është 4.07, që rezulton në atë se nxënësit janë të kënaqur sepse kanë arritur suksesin e pritur.

viii: Në fig.34 shpehet grafikisht niveli i satisfaksionit të nxënësve në lidhje me variablën se eksperiencia e të mësuarit në shkollën time është e shkëlqyeshme. Në bazë të tabelës 3, kjo variabël vlerësohet me një mesatare prej 3.95 pikëshe që do të thotë se nxënësit janë të kënaqur me eksperiencën e të mësuarit në shkollën e tyre.

4.4. Vlerësimi i nxënësve dhe vet-vlerësimi

Në pjesën në vazhdim, duke filluar nga fig. 35-38, do të shohim satisfaksionin e nxënësve me vlerësimin dhe vet-vlerësimin.




Fig.35: Satisfaksioni i nxënësve mbi shpjegimin e kriterëve në fillim të vitit shkollor.




Fig.36: Niveli i satisfaksionit të nxënësve mbi marrjen e notave brenda një periudhe të arsyeshme kohore.




Fig.37: Niveli i përpuetshmërisë së vet-vlerësimit me vlerësimin e profesorit.




Fig.38: Niveli i satisfaksionit të nxënësve se është në gjendje të vlerësojë njohuritë në mënyrë kritike.




Fig.39: Niveli i satisfaksionit të nxënësve në lidhje me atë se profesorët nuk bëjnë dallim gjatë vlerësimit.

Tabela e rezultateve deskriptive në lidhje me mesataret e fituara të këtyre pesë variablave është:

Tabela 7: Të dhënat nga statistika deskriptive për vlerësimin e nxënësve dhe vet-vlerësimin.

	P.1	P.2	P.3	P.4	P.5
N Valid	192	194	194	195	195
Missing	4	2	2	1	1
Mean	3.94	4.07	3.91	3.96	3.42
Median	4.00	4.00	4.00	4.00	4.00
Mode	5	5	5	5	5
Std. Deviation	1.156	1.038	1.088	1.143	1.532
Minimum	1	1	1	1	1
Maximum	5	5	5	5	5

Nga rezultatet e fituara kemi këto përfundime:

- i. Një përqindje dominante e nxënësve, edhe atë prej 42.9 % janë plotësisht të kënaqur mbi atë se kriteret e vlerësimit shpjegohen në fillim të viti shkollor duke dhënë vlerësim 5(fig. 35). Me të kënaqur janë deklaruar 21.9 % duke dhënë vlerësim 4, qëndrim neutral kanë mbajtur 20.9% e nxënësve. Opcionin të pakënaqur e kanë zgjedhur 8.7% dhe plotësisht të pakënaqur duke rrethuar numrin 1 janë deklaruar vetëm një përqindje e vogël nxënësish prej 3.6%. Mesatare e këtyre statistikave është 3.94, që do të thotë se nxënësit janë të kënaqur me variablën në fjalë.
- ii. Se rezultatet / notat e nxënësve merren brenda një periudhe të arsyeshme kohore, mund të konstatojmë prej grafikorit numër 36, shohim se 39.9% e nxënësve deklarohen se pajtohen plotësisht me këtë fakt duke shprehur plotësisht kënaqësinë më rrethimin e numrit 5, kurse 38.8% japin vlerësim 4 pikësh ku poashtu shprehin se janë të kënaqur. Prej përgjigjeve të fituara në vazhdim shohim se 11.7% janë neutral me këtë aspekt kurse 4.6% dhe 4.1% e nxënësve nuk janë të kënaqur duke dhënë vlerësim 2 dhe 1 përkatësisht. Pra, me një mesatare prej 4.07 pikëshe shprehet satisfaksioni i nxënësve se ato vlerësohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore.
- iii. Për sa i përket asaj se vet-vlerësimi i nxënësit përputhet me atë të profesorit (fig. 37), 36.2 % dhe 30.6% e nxënësve janë të këtij mendimi duke shprehur kënaqësinë me vlerësimin prej 5 pikësh dhe 4 pikësh përkatësisht. Poashtu, një numër i konsiderueshëm i nxënësve prej 23.5 % janë *neutral*, për të pasuar më pastaj pakënaqësia me 4.1% dhe 4.6% me një vlerësim prej 2 pikësh dhe 1 pikësh.
- iv. Një përqindje dominante e nxënësve prej 40.3 % mendojnë se janë në gjendje të vlerësojnë njohuritë e tyre në mënyrë kritike (fig.38), duke shprehur plotësisht kënaqësinë e tyre me dhënien e 5 pikëve. Me të kënaqur janë deklaruar 31.1 % të nxënësve dhe qëndrim neutral mbajnë 17.9 %. Opcionin të pakënaqur dhe plotësisht të pakënaqur e kanë përzgjedhur vetëm 4.1 % dhe 6.1% e nxënësve.

- v. Ajo që më së shumti u pengon nxënësve gjatë periudhës së procesit edukativo-arsimor, është dallimi që një profesor bën te nxënësit. Prandaj, përgjigja se profesorët nuk bëjnë dallim gjatë vlerësimit të nxënësve (fig.39), është vlerësuar në këtë mënyrë: 36.7% e nxënësve deklarojnë se janë plotësisht të kënaqur me këtë aspekt duke dhënë vlerësim maksimal 5 pikësh, 16.8% shprehen të kënaqur duke rrethuar 4 pikëshin, 15.3% me një vlerësim prej 3 pikësh, 12.2 % dhe 18.4% shprehen të pakënaqur dhe plotësisht të pakënaqur duke rrethuar numrin 2 dhe 1, përkatësisht. Vlerësimi prej 2 dhe 1 pikësh paraqet një përqindje të konsiderueshme që nuk mund të neglizhohet. Pra, nga statistikat e mësipërme me një mesatare prej 3.42 pikëshe, shprehet ajo se nxënësit janë *disi të kënaqur* në lidhje me lojalitetin e profesorëve gjatë vlerësimit të nxënësve.

4.5. Vlerësimi në lidhje me ndikimin e faktorëve tjerë relevant me ndikim (influencë)

Vlerësimi që japin nxënësit në lidhje me ndikimin e faktorëve tjerë relevant me ndikim do të demonstron në pjesën e mëposhtme, nga fig.40- fig. 45.




Fig. 40-41: Opinioni i nxënësve në lidhje me atë se a organizohen trajnime nga ana e Ministrisë dhe Entit Pedagogjik dhe se a bëhet selektimi në mënyrë korekte.

i-ii: Në mënyrë anonime, me një përqindje prej 40.8% nxënësit janë shprehur se nuk organizohen trajnime nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Entit Pedagogjik. Poashtu, me të njëjtën përqindje në

mënyrë të rastësishme prej 40.8% një grup nxënësish janë shprehur se *nuk e dijnë*. Këto janë dy opcionet dominante, pasi që opcioni *Po* është dukshëm i vogël edhe atë me 17.3% (fig.40). Në lidhje me atë se a bëhet selektimi në mënyrë korrekte (fig. 41), 35.7 % e nxënësve janë shprehur se *po*, 22.4 % e nxënësve janë shprehur se *jo* kurse një përqindje më e madhe e nxënësve prej 39.8% janë shprehur se *nuk e dijnë*.




Fig. 42-43: Opinioni i nxënësve se a organizohen pjesëmarrje në projekte nga institucionet e jashtme dhe se a bëhet selektimi në mënyrë korekte sipas meritës.

iii-iv: Në bazë të grafikut, në lidhje me atë se a organizohen pjesëmarrje në projekte nga institucionet e jashtme, përqindja më e madhe e nxënësve prej 39.8 % shprehen se nuk e dijnë . Vetëm 25% e nxënësve shprehen se *po* kurse një përqindje e konsiderueshme prej 32.1 % shprehen se *jo* (fig.42). Për sa i përket asaj se a bëhet përzgjedhja në mënyrë korrekte, 39.3% janë shprehur se *po*, 24.5% janë shprehur se *jo* dhe 33.7% janë shprehur të reatë se *nuk e dijnë* (fig.43).




Fig. 44-45: Opinioni i nxënësve se a organizohen gara shkollore në lëmi të ndryshme dhe se a janë të kënaqur me të arriturat nga këto gara.

v-vi: Siç duket nga fig.44, një grup i madhë i nxënësve prej 64.3 % janë në dijeni për organizimin e garave në lëmi të ndryshme dhe poashtu një përqindje e konsiderueshme prej 46.9 % janë të kënaqur me të arriturat e shkollës në këto gara (fig.45).

KAPITULLI I PESTË

5. DISA VARSHMËRI TË RËNDËSISHME

5.1. Kros-tabulimet dhe disa varshmëri signifikante

Një varshmëri e fuqishme ekziston në mes variablës se “ Profesorët kanë njohuri të gjëra në lëndën e tyre “ dhe variablës “ Gjatë ndjekjes së procesit edukativo - arsimor kam fituar njohuri të përgjithshme në fusha të ndryshme”. Tabela 8 e jep Chi-Square koeficientin:

Tabela 8: Chi-square testi i varshmerise ne mes njohurive të mësimdhënësve dhe njohurive të nxënësve.

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	43.459 ^a	16	.000
Likelihood Ratio	34.512	16	.005
Linear-by-Linear Association	13.923	1	.000
N of Valid Cases	195		

a. 17 cells (68.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .25.

Këtu varshmëria është në shkallën maksimale prej 100%, pasi që koeficienti i Pirsonit e ka vlerën 0.000. Pra, nxënësit që pajtohen me atë se profesorët kanë njohuri të gjera në lëndën e tyre vlerësojnë edhe vetveten në të njëjtën mënyrë.

E njëjta gjë mund të konkludohet edhe për nivelin e vlerësimit të variablës “ Profesorët kanë aftësi të mira mësimore “ kundrejt variablës “ Unë kam përmirësuar aftësitë e mia për të mësuar në mënyrë efektive, për të ndjekur idetë dhe për të gjetur informacionin që kam nevojë”. Këtu koeficienti i Pirsonit është 0.00 që do të thotë se këto variabla janë të varura 100% prej njëra-tjetrës. Tabela e mëposhtme jep edhe një dëshimi të plotësimit të hipotezës se “ Nxënësit janë të kënaqur me profesionalizmin e mësimdhënësve”.

Tabela 9: Chi-square testi i varshmerise ne mes aftësive të mësimdhënësve dhe aftësive të nxënësve.

	Value	Df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	61.831 ^a	16	.000
Likelihood Ratio	36.868	16	.002
Linear-by-Linear Association	18.518	1	.000
N of Valid Cases	193		

a. 16 cells (64.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .02.

Poashtu, një varshmëri signifikante ekziston në mes variablave “ Cilësia e bashkëveprimeve me të gjithë punonjësit e përfshirë në shkollë është e shkëlqyeshme” dhe “ Eksperienca e të mësuarit në shkollën time është e shkëlqyeshme”. Në lidhje me këtë pyetje e kemi kros-tabulimin e mëposhtëm në tabelën 10 si dhe Chi-square testin në tabelën 11:

Tabela 10: Kros-tabulimi në mes cilësisë së bashkëveprimeve me punonjësit e shkollës kundrejt eksperiencës së të mësuarit në shkollë.

	Cilësia e bashkëveprimeve me të gjithë punonjësit e shkollës					Total
	1	2	3	4	5	
Eksperiencia e të mësuarit në shkollë	1	2	3	4	5	
	4	2	1	1	3	11
	0	1	3	7	4	15
	2	3	23	11	7	46
	1	2	8	26	20	57
	1	1	6	13	41	62
Totali	8	9	41	58	75	191

Tabela 11: Chi-square testi i varshmerise ne mes cilësisë së bashkëveprimeve me punonjësit e shkollës dhe ekperiencës së të mësuarit.

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	88.633 ^a	16	.000
Likelihood Ratio	68.467	16	.000
Linear-by-Linear Association	33.277	1	.000
N of Valid Cases	191		

a. 15 cells (60.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .46.

Prej më sipër shihet që koeficienti i Pirsonit është 0.00 , që do të thotë se këto dy variabla janë të varura 100% nga njëra-tjerta. Pra, nxënësit që janë të kënaqur në aspektin e cilësisë së bashkëveprimeve me punonjësit e përfshirë në shkollë janë të kënaqur edhe me eksperiencën e

të mësuarit në atë shkollë. Atëherë, nga tabelat 8, 9 dhe 11 shohim që plotësohet edhe hipoteza e parë e këtij hulumtimi që thotë se “Nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Tetovës janë të kënaqur me cilësinë e shërbimeve arsimore”.

Një varshmëri signifikante e ndjeshme prej 0.02 d.m.th 98% që vlen të theksohet, është fakti se suksesi i vitit paraparak është i lidhur ngushtë me nivelin e vlerësimit të variablës “Unë kam arritur suksesin tim të pritur”. Koeficienti i Pirsonit shihet qartë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 12.: Chi-square testi i varshmerise ne mes aftësive të mësimdhënësve dhe aftësive të nxënësve.

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	30.966 ^a	12	.002
Likelihood Ratio	33.872	12	.001
Linear-by-Linear Association	10.061	1	.002
N of Valid Cases	196		

a. 9 cells (45.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .33.

Një varshmëri e lartë dhe e logjikshme me koeficient 0.017, që është shumë më e vogël se vlera referente prej 0.05, ekziston edhe në mes rekomandimit të shkollës dhe variablës “*Eksperienca e të mësuarit në shkollën time është e shkëlqyeshme*”. Kjo do të thotë që nxënësit, të cilët do t’ua

rekomandonin shkollën e tyre ndonjë të afërmi apo miku, plotësisht pajtohen me atë se eksperienca e të mësuarit në shkollën e tyre është e shkëlqyeshme. Tabela e kros-tabulimit, tabela e Pirsonit si dhe grafiku i kros-tabulimit janë si në vijim:

Tabela 13: Kros-tabulimi në mes rekomandimit të shkollës dhe eksperiencës në të.

		Eksperienca e të mësuarit në shkollën time është e shkëlqyeshme					Total
		1	2	3	4	5	
Rekomandi mi	Po	3	3	27	47	65	145
	Jo	4	2	8	5	6	25
	Nuk e di	1	1	4	3	6	15
Totali		8	6	39	55	77	185

Tabela 14: Chi-square testi i varshmerise ne mes rekomandimit të shkollës dhe eksperiencës në të.

	Value	Df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	18.590 ^a	8	.017
Likelihood Ratio	15.466	8	.051
Linear-by-Linear Association	7.648	1	.006
N of Valid Cases	185		

a. 7 cells (46.7%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .49.




Fig .46: Rekomandimi i shkollës në varësi të eksperiencës në të.

Në tabelën e mëposhtme, shohim një varshmëri të lartë në mes variablave: “Vlerësimi im për arritjet e mia përputhet me atë të profesorit tim” dhe asaj se “Profesorët nuk bëjnë dallim gjatë vlerësimit të nxënësve”. Këtu koeficienti i Pirsonit është 0.000, që tregon se këto variabla janë plotësisht të varura prej njëra-tjetrës në një nivel prej 100%.

Tabela 15: Chi-square testi i varshmërisë në mes vlerësimit nga ana e profesorit dhe vet-vlerësimit.

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	43.691 ^a	16	.000
Likelihood Ratio	46.560	16	.000
Linear-by-Linear Association	17.272	1	.000
N of Valid Cases	194		

a. 10 cells (40.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .99.

Një varshmëri e rëndësishme ekziston edhe në mes variablës “Profesorët dhe stafi mbështetës i shkollës janë të shqetësuar për mirëqenien dhe interesat e nxënësve “ dhe variablës “Kam zhvillur një kod personal të vlerave dhe etikës (moralit)“. Në këtë rast koeficienti i Pirsonit është 0.023 që është vlerë më e vogël se 0.05, prandaj konkludojmë se sjellja e profesorëve dhe stafit udhëheqës të shkollës poashtu ndikon në sjelljen dhe afirmimin e këtyre vlerave te nxënësit.

Tabela 16: Chi-square testi – Profesorët dhe stafi mbështetës shqetësohen për mirëqenien dhe interesat e nxënësve kundrejt faktit që nxënësi ka zhvilluar një kod personal të vlerave dhe etikës.

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	29.138 ^a	16	.023
Likelihood Ratio	27.479	16	.036
Linear-by-Linear Association	10.377	1	.001
N of Valid Cases	187		

a. 15 cells (60.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .22.

Nga ana tjetër, sipas rezultateve të fituara nga përgjigjet e nxënësve mund të konstatohet se kemi edhe variabla të cilat janë plotësisht të pavarura nga njëra-tjetra, respektivisht raste kur njëra variabël nuk ka aspak ndikim tek variabla tjetër. Ashtu është për shembull rasti në mes suksesit të nxënësit dhe rekomandimit të shkollës në të cilën ai mëson. Kros-tabulimi i kësaj varshmërie është dhënë si më poshtë:

Tabela 17: Kros-tabulimi i suksesit të nxënësit dhe rekomandimit të shkollës.

		Rekomandimi			Totali
		Po	Jo	Nuk e di	
Suksesi	Mjaftueshëm	13	1	2	16
	Mirë	36	7	7	50
	Shumë mirë	52	5	4	61
	Shkëlqyeshëm	45	12	3	60
Total		146	25	16	187

Nivelin e këtij ndikimi më së miri e tregon tabela e Chi-Square testit:

Tabela 18: Kros-tabulimi i varshmerise ne mes suksesit të nxënësit dhe rekomandimit të shkollës.

	Value	Df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	7.741 ^a	6	.258
Likelihood Ratio	7.685	6	.262
Linear-by-Linear Association	.600	1	.439
N of Valid Cases	187		

a. 3 cells (25.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 1.37.

Nga kjo tabelë shohim që koeficienti i Pirsonit për këtë varshmëri është 0.258, që është shumë më e madhe se vlera referente prej 0.05 dhe konkludohet se nuk ekziston varshmëri në mes këtyre dy variablave. Pra, se suksesi i nxënësit nuk ka ndikim në rekomandimin e shkollës duket edhe në grafikonin më poshtë:




Fig. 47: Ndikimi në mes suksesit të nxënësve dhe rekomandimit.

Poashtu, suksesi i nxënësit nuk ka ndikim në variablën se “Profesorët nuk bëjnë dallim gjatë vlerësimit të nxënësve”. Do të thotë që, niveli i sinjeritetit gjatë vlerësimit të kësaj variable aspak nuk ndikohet nga ajo se me çfarë suksesi është nxënësi. Në këtë rast, koeficienti i Pirsonit është 0.236 që është shumë më e madhe se vlera referente prej 0.05, prandaj këto dy faktorë janë plotësisht të pavarur. Më poshtë e kemi tabelën 19 që e verifikon këtë analizë.

Tabela 19: Chi- Square testi në mes suksesit të nxënësit dhe vlerësimit real nga ana e profesorit.

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	15.097 ^a	12	.236
Likelihood Ratio	14.778	12	.254
Linear-by-Linear Association	2.132	1	.144
N of Valid Cases	195		

a. 4 cells (20.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 1.97.

Prej më sipër konstatohet se hipoteza 7 që thotë : “Profesorët nuk bëjnë dallim gjatë vlerësimit të nxënësve” nuk plotësohet sepse koeficienti i *Pirsonit* është 0.236 >0.05. Më poshtë është dhënë tabela e varshmërisë ndërmjet suksesit të nxënësve në lidhje me opinionin për sa i përket ndikimit të reputacionit të shkollës për të mësuar. Vlera e koeficientit është 0.047 < 0.05. Kjo do të thotë se satisfaksioni nga reputacioni i shkollës ndikon në arritjen e suksesit në shkollë. Me këtë vërtetohet hipoteza 8.

Tabela 20: Chi- Square testi në mes suksesit të nxënësit dhe reputacionit të shkollës.

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	12.789 ^a	6	.047
Likelihood Ratio	12.374	6	.054
Linear-by-Linear Association	8.155	1	.004
N of Valid Cases	180		

a. 2 cells (16.7%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 2.82.

Në mënyrë të ngjajshme çuditërisht, gjinia e nxënësit nuk ndikon në suksesin e tij edhe pse çdo herë themi se vajzat mësojnë më shumë se djemtë.

Tabela 21: Chi- Square testi i suksesit versus gjinisë.

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	8.554 ^a	6	.200
Likelihood Ratio	8.704	6	.191
Linear-by-Linear Association	2.214	1	.137
N of Valid Cases	196		

a. 4 cells (33.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .08.

Tabela e mësipërme tregon qartë se vlera signifikante është 0.200 që është më e madhe se vlera referente prej 0.05, prandaj edhe verifikohet që këto variabla nuk janë të varura nga njëra-tjetra.

Rast tjetër për pavarësinë e variablave është edhe vendbanimi kundrejt suksesit. Se këto variabla nuk kanë ndikim në njëra tjetrën e shohim në tabelat e mëposhtme.

Tabela 22: Kros-tabulimi në mes vendbanimit dhe suksesit.

	Suksesi				Totali
	Mjaft.	Mirë	Sh.mirë	Shkëlq.	
Vendbanimi Fshat	11	28	32	28	99
Qytet	5	27	29	32	93
Totali	16	55	61	60	192

Tabela 23: Chi-Square testi i varshmërisë në mes vendbanimit dhe suksesit.

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	2.497 ^a	3	.476
Likelihood Ratio	2.551	3	.466
Linear-by-Linear Association	1.484	1	.223
N of Valid Cases	192		

a. 0 cells (0.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 7.75.

Nga tabela 23, shohim që faktori signifkant është 0.476 që shumë më i madhë se vlera e lejuar prej 0.05. Prandaj, fakti që nxënësi i takon zonës rurale apo urbane, nuk ndikon në suksesin e tij në mësim. Më poshtë shohim edhe grafikonin e këtij kros-tabulimi:




Fig. 48: Grafiku i kros-tabulimit në mes venbanimit dhe suksesit.

Poashtu edhe nga grafikoni, shumë qartë duket që këto variabla nuk janë të nvarura njëra prej tjetrës, meqë sukcesi në mes nxënësve që vijnë nga fshati dhe atyre nga qyteti është relativisht i njëjtë. Në mënyrë të ngjajshme analizuar që, viti në të cilin nxënësit ndjekin mësimin nuk ndikon në suksesin e tyre. Vlera signifikative për këto variabla është 0.138 që është më e madhe se vlera e lejuar. Këtë e vërteton tabela e mëposhtme:

Tabela 24: Chi-Square testi i varshmërisë në mes vitit të studimit dhe suksesit .

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	17.317 ^a	12	.138
Likelihood Ratio	17.292	12	.139
Linear-by-Linear Association	.247	1	.620
N of Valid Cases	196		

a. 4 cells (20.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 2.12.

Për këtë rast kemi përfshirë edhe një shkollë fillore, në mënyrë që të mund të bëjmë krahasim më të mirë ndërmjet asaj se a ndikon mosha e nxënësit në kënaqësinë e tij për të mësuar. Mirëpo rezultatet treguan që këto faktor nuk janë të nvarur prej njëri-tjetrit.

5.2 Analiza e regresionit dhe korelacionit

Duke pasur parasysh rezultatet e paragrafit të dytë, tretë, katërt dhe pesë të pyetësorit të përpiluar për këtë hulumtim, bazës së të dhënave në *Excel* i shtuam edhe katër kolona të reja me titujt përkatës të paragrafeve edhe atë: bashkëveprimet, mjedisi, eksperiencia dhe vlerësimi. Këto katër kolona paraqesin shumën e rezultateve të përgjigjeve të pyetjeve nëpër paragrafet përkatëse dhe në softuerin SPSS do të thotë që u shtuan edhe katër variabla të reja. Këtë e kemi bërë me qëllim që këto kategori, respektivisht paragrafe ti përmbledhim me një analizë të përgjithshme, duke parë edhe varshmërinë e paragrafeve në mes veti si një varshmëri e përgjithshme përvec analizave të faktorëve individual të bërë deri më tani.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur rezultatet e statistikës deskriptive për këto katër vlera përmbledhëse të të gjithë faktorëve.

Tabela 25: Rezultatet e statistikës deskriptive për katër vlerat përmbledhëse të të gjithë faktorëve.

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Bashkeveprimet_12345678910	198	3.8	50.0	38.310	8.3896
Mjedisi_123456789101	198	3.4000	55.0000	37.510524	9.4578471
Eksperienca_123456789	198	4.1000	40.0000	33.153541	5.7022717
Vleresimi_12345	198	.0000	25.0000	19.009529	4.1039968
Valid N (listwise)	198				

Prej rezultateve në tabelë duke i marrë parasysh mesataret, shohim se ato tentojnë kah vlera përmbledhëse maksimale, respektivisht tendenca është kah faktori pozitiv sipas shkallës së Likertit. Kjo tregon se satisfaksioni ndaj të gjithë parametrave të shtruar është në nivel të lartë ku dominon pjesa e bashkëveprimeve, kjo pason me satisfaksionin nga mjedisi, pastaj vjen eksperienca dhe nivel më të ulët ka pjesa e satisfaksionit në lidhje me pjesën e vlerësimeve. Sipas kësaj konstatojmë se plotësohet edhe hipoteza 1. Këtë konstatim e bazojmë nga tabela 25 për shumën e vlerave ku mesatarja është më afër vlerës maksimale, e duke marrë parasysh se maksimumi i shkallës së Likertit është "plotësisht pajtohem", mund të konkludohet se kënaqësia me cilësinë në lidhje me shërbimet e llojeve të ndryshme është e kënaqshme.

Më poshtë e bëjmë analizën e regresionit të shumëfishtë. Me qëllim që të bëhet regresioni, njërin variabël e marrim si variabël të varur (X), ndërsa të tjerat si variabla të pavarura (Y1, Y2, etj.). Dëshirojmë të analizojmë varshmërinë e variablës në lidhje me kategorinë e vlerësimeve ndaj variablave të bashkëveprimeve, eksperiencave dhe kushteve mjedisore. Prandaj, variablën e parë (e që janë rezultatet përmbledhëse nga kategoria e vlerësimeve) e vendosim në kategorinë e variablës së varur, ndërsa tre të tjerat (e që janë rezultatet përmbledhëse nga kategoria e bashkëveprimeve, eksperiencave dhe kushteve mjedisore) në kategorinë e variablave të pavarura. Me këtë rast e shfrytëzojmë *stepwise* metodën që të bëjmë analizën hap pas hapi.

Tabela e parë që fitohet është tabela për variablat të cilat janë në korelacion në lidhje me regresionin. Ekuacioni i përgjithshëm matematikor për regresionin është $X=a+b_1*Y_1+b_2*Y_2+...+b_n*Y_n$, ku X është variabla e varur, ndërsa Y1, Y2, ... , Yn janë variablat e pavarura.

Tabela 26: Korelacioni i variablave në lidhje me regresionin.

Model	Variables Entered	Variables Removed	Method
1	Bashkeveprimet_12345678910		. Stepwise (Criteria: Probability-of-F-to-enter <= .050, Probability-of-F-to-remove >= .100).
2	Eksperienca_123456789		. Stepwise (Criteria: Probability-of-F-to-enter <= .050, Probability-of-F-to-remove >= .100).

a. Dependent Variable: Vleresimi_12345

Prej tabelës shohim se vetëm bashkëveprimet dhe faktorët e eksperiencës janë të lidhura në mënyrë signifikante me vlerësimet. Rezultatet për mjedisin nuk janë signifikante për të bërë regresionin ndaj vlerësimeve. Pra, me metodën stepwise, SPSS direkt gjeneron dhe i paraqet informacion vetëm për ato variabla që kanë ndikim signifikant ndaj variablës së varur ku vlera referente është 0.05, respektivisht me saktësi prej 95%. Tabela e radhës është tabela model summary.

Tabela 27: Model summary.

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.595 ^a	.354	.351	3.3062252
2	.630 ^b	.397	.391	3.2039958

Prej tabelës së sipërme shohim se variabla e parë e pavarur e që është faktori i bashkëveprimeve mund të sqaron $0.354 \cdot 100\% = 35.4\%$ e variancës të variablës së varur të vlerësimeve. Ndërsa variabla e dytë e pavarur e që është faktori i eksperiencave mund të sqaron 39.7% të variancës së variablës së varur të vlerësimeve. Kjo tabelë poashtu nuk e paraqet faktorin e tretë të mjedisit pasi që ai faktor statistikisht sipas rezultateve nuk ishte signifikant. Në bazë të kësaj konstatojmë plotësimin e hipotezës 3, kjo pasi që sipas analizës së sipërme del se kategoria në lidhje me vlerësimet e përgjithshme të nxënësve është e varur prej kategorisë së bashkëveprimeve (që ka të bëjë me paragrafin e dytë të pyetjeve e që kryesisht lidhet me mendimin e tyre për profesorët dhe stafin). Poashtu sipas logjikës së njëjtë vijmë deri te plotësimi i hipotezës 5 pasi që vlerësimi i përgjithshëm është i varur edhe nga eksperiencia e tyre (pyetjet e paragrafit 4) ku dominojnë aftësimi i tyre në lidhje me çështje të ndryshme që nuk mund të bëhet pa shfrytëzimin e resurseve të nevojshme për lëndët që i ndjekin. Plotësimi i hipotezës së 6 është për të njëjtën arsye si rasti i hipotezës 3 pasi që këto pyetje gjenden në atë paragraf.

Konstatimet e bëra më sipër i përforcojmë edhe nëpërmjet vazhdimit të kësaj analize nëpërmjet tabelës ANOVA. Kjo tabelë bën testimin e signifikancës së modelit të regresionit.

Tabela 28: Testimi i signifkancës së modelit të regresionit.

ANOVA^c

Model	Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
1 Regression	1175.529	1	1175.529	107.540	.000 ^a
Residual	2142.500	196	10.931		
Total	3318.030	197			
2 Regression	1316.240	2	658.120	64.109	.000 ^b
Residual	2001.790	195	10.266		
Total	3318.030	197			

Kolona sig e jep vlerën signifkante që është $0.000 < 0.05$ që tregon se është vlerë e pershtatshme. Vlera kritike e F vlerës është 3.9 për variablën e parë të pavarur (kemi shfrytëzu online kalkulatorin për llogaritjen e F-vlerës duke marrë shkallën e parë të $df=1$ dhe të dytën $df=196$ që janë fituar në tabelë) dhe 3.04 për variablën e dytë (ku shkalla e parë është marrë vlera tabelare $df=2$ dhe për të dytën $df=195$). Në të dyja rastet kemi fituar vlerë më të madhe se vlera kritike për F vlerën (për të parën 107.5 dhe për të dytën 64.1), dhe kjo na tregon se efektet statistikisht janë signifkant.

Tabela e radhës është tabela e koeficientëve.

Tabela 29: Tabela e koeficientëve.

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	7.855	1.101		7.134	.000
	Bashkeveprimet_12345678910	.291	.028	.595	10.370	.000
2	(Constant)	4.533	1.394		3.252	.001
	Bashkeveprimet_12345678910	.223	.033	.456	6.788	.000
	Eksperiencia_123456789	.179	.048	.249	3.702	.000

Koeficienti beta jep informatë për shkallën e kontributit të secilës variabël signifikante të pavarur. Sipas tabelës se mësipërme kemi dy modele.

Modeli 1:

$$\text{vleresimet} = 7.855 + 0.291 * \text{bashkeveprimet}$$

Prej këtij modeli përfundojmë se me rritjen e nivelit të bashkëveprimeve për një njësi, vlerësimet rriten për 0.291% dhe kjo varshmëri është signifikante pasi $\text{sig} < 0.05$. Pra, edhe një vërtetim se

këto dy kategori ndikojnë linearisht me proporcion të drejtë (pra, me rritjen e bashkëveprimeve, rritet shkalla e nivelit të vlerësimeve).

Modeli 2:

$$\text{vleresimet} = 4.533 + 0.223 * \text{bashkeveprimet} + 0.179 * \text{eksperienca}$$

Prej këtij modeli përfundojmë se me rritjen e nivelit të bashkëveprimeve për një njësi, vlerësimet rriten për 0.223% , dhe me rritjen e nivelit të eksperiencave për një njësi, vlerësimet rriten për 0.179%. Kjo varshmëri është poashtu signifikante pasi $\text{sig} < 0.05$.

Me analizën e mësipërme edhe njëherë vërtetohet plotësimi i hipotezës 3, hipotezës 5 dhe hipotezës 6, të cilat ngërthehen në keto kategori.

Tabela 30 e jep variablën e pavarur përjashtuese që është faktori i mjedisit.

Tabela 30: Variabla e pavarur përjashtuese - faktori i mjedisit.

Model	Beta In	t	Sig.	Partial Correlation	Collinearity Statistics	
					Tolerance	
1	Mjedisi_123456789101	.044 ^a	.583	.560	.042	.583
1	Eksperienca_12345678	.249 ^a	3.702	.000	.256	.686
2	Mjedisi_123456789101	.018 ^b	.243	.808	.017	.578
1						

Shohim se faktori signifikant është $0.583 > 0.05$. Kjo do të thotë se mjedisi nuk mund të lidhet në variablën e varur të vlerësimeve. Rrjedhimisht, me regresion nuk mund të konstatojmë diçka të dukshme, respektivisht signifikante për ndikimin e mjedisit në satisfaksionin e nxënësve.

Në vazhdim do të japim tabelën e korelacionit ndërmjet parametrave: bashkëveprimet, mjedisi, eksperiencia dhe vlerësimi.

Tabela 31: Tabela e korelacionit ndërmjet parametrave: bashkëveprimet, mjedisi, eksperiencia dhe vlerësimi.

		Bashkeveprimet_12345678 910	Mjedisi_123456789 1011	Eksperiencia_123456789 89	Vleresimi_12345 12345
Bashkeveprimet_12345678910	Pearson Correlation	1	.617**	.509**	.561**
	Sig. (2-tailed)		.000	.000	.000
	N	196	196	196	196
Mjedisi_123456789101	Pearson Correlation	.617**	1	.366**	.367**
	Sig. (2-tailed)	.000		.000	.000
	N	196	196	196	196
Eksperiencia_123456789	Pearson Correlation	.509**	.366**	1	.454**
	Sig. (2-tailed)	.000	.000		.000
	N	196	196	196	196
Vleresimi_12345	Pearson Correlation	.561**	.367**	.454**	1
	Sig. (2-tailed)	.000	.000	.000	
	N	196	196	196	196

Në bazë të tabelës së mësipërme, shohim se ekziston një korelacion linear ndërmjet këtyre katër faktorëve, edhe atë korelacioni është pozitiv dhe shumë signifikant (vlera e signifikancës është $0.000 < 0.05$). Korelacion më i fuqishëm ekziston ndërmjet faktorit bashkëveprimet me faktorin

mjedisi. Ajo vlerë është 0.617. Kjo do të thotë që me rritjen e kushteve dhe sigurimit të mjedisit më të përshtatshëm për mësim dhe punë, rritet edhe niveli i bashkëveprimeve të nxënësve me profesorët dhe stafin mbështetës të shkollës. Kjo analizë bën vërtetimin e hipotezës së tetë.

KAPITULLI I GJASHTË

6. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

6.1 Përfundimet

Ekzistojnë faktorë të ndryshëm brenda dhe jashta klasës që kontribuojnë në arritjen e suksesit të nxënësve. Ky punim u fokusua vetëm në nivelin e satisfaksionit dhe nevojave të nxënësve në zhvillimin e procesit edukativo – arsimor në shkollat e mesme të Komunës së Tetovës. Duke marrë parasysh faktin e shtruar më sipër, nëpërmjet kësaj teme kam dhënë një kontribut në lidhje me situatën faktike të nivelit të satisfaksionit të nxënësve me procesin arsimor.

Fillimisht shtruar tetë hipoteza, të cilave donim t'u japim përgjigje se a janë të vlefshme edhe për nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Tetovës. Vërtetimin e këtyre hipotezave e kemi bërë duke analizuar përgjigjet e dhëna nga ana e nxënësve. Për këtë arsye, përveç të dhënave të statistikës deskriptive në lidhje me mesataret e variablave përdorëm edhe varësitë signifikative, krostabulimet, analizën e regresionit dhe korelacionit duke e shfrytëzuar koeficientin Chi-Square të Pirsonit. Në bazë të rezultateve të fituara konstatoam se shtatë hipoteza plotësohen dhe një jo. Hipoteza e shtatë nuk plotësohet. Vlen të theksohet se analiza e bërë në këtë punim ka qenë gjithëpërfshirëse, duke vlerësuar pothuajse të gjithë faktorët potencial që ndikojnë në satisfaksionin e nxënësve me mësimin aktual.

Në kapitullin e parë kemi bërë një hyrje detale për problemin në fjalë, pastaj kemi dhënë përkufizimin e satisfaksionit, qëllimin e të mësuarit në shkollë në bazë të botëkuptimeve të ndryshme nëpër shtetet më të zhvilluara të botës.

Në kapitullin e dytë kemi bërë një analizë të përgjithshme të literaturës dhe të kërkimeve të ndryshme për këtë problematikë nga autorë të tjerë.

Për sa i përket kapitullit të tretë kemi dhënë informata të përgjithshme në lidhje me metodat që i shfrytëzuam për hulumtimin e temës në fjalë. Pastaj pason kapitulli i katërt ku edhe janë dhënë rezultatet bazë të këtij punimi. Kemi bërë analizën individuale të përgjigjeve të nxënësve të parashtruara në pyetësonin adekuat, duke dhënë përqindjen përkatëse të frekuencave, analiza të statistikës deskriptive, si dhe grafikone dhe tabela përkatëse të këtyre analizave.

Në kapitullin e pestë kemi analizuar varshmëritë signifikative ndërmjet variablave në bazë të vlerës së fituar të koeficientit të Pirsonit, kros-tabulimet, analizën e regresionit dhe korelacionit. Pastaj pason kapitulli i gjashtë me përfundim përmbyllës dhe rekomandim.

Të dhënat nga hulumtimi tregojnë se me një mesatare prej 3.76, në një shkallë 5 pikëshe të Likërit në nivel të paragrafeve të pyetësorit, nxënësit e shkollave të mesme të Komunës së Tetovës janë të kënaqur me zhvillimin e procesit edukativo-arsimor në këtë rajon edhe atë me: cilësinë e bashkëveprimeve me të gjithë punonjësit e shkollës, cilësinë e mjedisit mësimor në shkollë, eksperiencën mësimore, vlerësimin nga ana e profesorëve, vet-vlerësimin, pjesëmarrjen e tyre nëpër trajnime, projekte dhe gara shkollore nëpër lëndë të ndryshme.

6.2 Rekomandimet

Menaxhimi i mirëfilltë i një institucioni edukativo-arsimor duhet të rregullohet me ligj, me udhëzim administrativ dhe me dokumente tjera zyrtare që janë në fuqi. Që të mbizotrojnë një klimë pozitive në shkollë, duhet të ket një bashkëpunim shkollë-prind-nxënës. Andaj, nga ky hulumtim dalin disa rekomandime të posaçme për stafin udhëheqës të shkollës, për mësimdhënësit dhe për prindërit e nxënësve.

Për stafin udhëheqës të shkollës:

- Të japin effort në mirëmbajtjen e kushteve të përgjithshme që ofron shkolla.
- Të inkurajohen mësimdhënësit në mënyrën se si e realizojnë orën mësimore.

- Te vazhdojnë ti përkrahin mësimdhënësit pasi që në përgjithësi nxënësit janë të kënaqur nga përgatitja e tyre.
- Të merren në konsideratë mendimet, idetë e mësimdhënësve në marrjen e vendimeve në lidhje me nxënësit.
- Të përkrahen mësimdhënësit në iniciativa që kanë për qëllim mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor.
- Të bashkëpunojnë me mësimdhënësit, të kenë një komunikim të rregullt që të mund të krijohet një besim reciprok si parakusht për një shkollë të suksesshme dhe cilësore.

Për mësimdhënësit:

- Të krijojnë klimë pozitive në klasë dhe të mbizotrojnë frymë miqësore në mesin e nxënësve.
- Të vazhdojnë në përdorimin e metodave sa më efektive gjatë spjegimit duke i'u përshtatur kohës dhe duke pasur parasysh moshën e ndjeshme të nxënësve gjithnjë duke i persosur të njëjtat.
- Të bashkëpunojnë me stafin udhëheqës të shkollës për rastet specifike me nxënës.
- Ta ngrit nivelin e bashkëpunimit me nxënësit duke i marrë në konsideratë mendimet e tyre për çështje të caktuara.
- Të udhëheq dhe të organizojë aktivitete me karakter garues brenda dhe jashta shkollës.
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve që ofrojnë për nxënësit është faktor shumë i rëndësishëm në satisfaksionin e nxënësve, prandaj duhet që mësimdhënësit t'i kushtojnë vëmendje kësaj çështje.

Për prindërit:

- Të marrin pjesë në mbledhjet e organizuara prindërore.
- Te mos kene brenga qe profesoret bejne dallimin ne mes nxenesve.
- Të kultivojnë dhe rruajnë trekëndëshin kujdestar klase - prind – nxënës.

- Të vëzhgojnë të mësuarit e fëmijëve të tyre në shtëpi dhe detyrat e shtëpisë duke u bazuar në tekstet shkollore perkatëse.
- Reputacioni i shkolles nuk është faktor kyç për arritjen e suksesit, prandaj jo me çdo kusht duhet të ketë tendence që fëmijët e tyre të regjistrohen në shkollat që në rrethin ku jetojnë njihen me reputacionin më të madhë.

6.3 Përfundim përmbyllës

Duke u bazuar në gjetjet e kësaj çështje dhe gjithë asaj që u tha më lartë, për t'u rritur niveli i satisfaksionit të nxënësve me procesin arsimor në shkollat e mesme të Komunës së Tetovës, të jetë pse jo edhe më i lartë se 3.76 të cilën ata e dhanë si vlerësim nga shkalla më e lartë 5 pikëshe e Likertit, shkolla duhet të funksionojë si një ekip. Duhet të funksionojnë të gjitha organet e shkollës, duhet të respektohen oraret, të ndahen detyrat, përgjegjësitë dhe llogaridhëniet, të përcaktohen prioritetet dhe të bashkëpunohet më shumë me prindërit e nxënësve në mënyrë që shkollat shqiptare të këtij rajoni të kenë një performancë të shkëlqyer.

REFERENCAT

- Afzal, H., Ali, I., Khan, M., & Hamid, K. (2010). A Study of University Students: Motivation and Its Relationship with Their Academic Performance. *International Journal of Business and Management*, 5(4), 80-88.
- Aldemir, C. and Gulcan, Y. (2004), "Students Satisfaction in Higher Education: A Turkish Case", *Higher Education Management and Policy*, 16(2), 109-122.
- Aldridge, S. and Rowely, J. (1998), "Measuring customer satisfaction in higher education", *Quality Assurance in Education*, 6(4), 197-204.
- Alexandris, K., & James, J. (2002). Measurement of Internal Service Quality: Application of SERVQUAL Battery to internal Service Quality, *Managing Service Quality*, 12(5), 278-291 .
- Alves, H., & Raposo, M. (2007) Conceptual Model of Student Satisfaction in Higher Education. *Total Quality Management*, Universidade de Beira Interior, Covilha~, Portugal, 18(5), 571-588.
- Athanassopoulos, A., Gounaris, S ., & Stathakopoulos, V. (2001). Behavioral Responses to Customer Satisfaction: an empirical study. *European Journal of Marketing*, 35(5-6), 687-707.
- Brunat, E.(2006). The importance of higher education to attract investment and contribute to sustain economic growth and competitiveness in Kaliningrad. *Baltic Rim Economic, Bimonthly Review*, 3f 2006 .
- Coleman, S. (2005). The Impact of Human Capital Measures on Firm Performance: A Comparison by Gender, Race, and Ethnicity. *The Journal of Entrepreneurial Finance & Business Ventur*, 10(5), 38-56.

- Danish, R., Malik, M., & Usman, A. (2010). The Impact of Service Quality on Students' Satisfaction in Higher Education Institutes of Punjab. *Journal of Management Research*, 2(2).
- DeShields Jr., O. W., Kara, A. and Kaynak, E. (2005), "Determinants of business student satisfaction and retention in higher education: applying Herzberg's two factor theory", *International Journal of Educational Management*, 19(2), 28-139.
- Druzdzal, M. J. and Glymour, C. (1995), "Application of the TETRAD II program to the study of student retention in US colleges".
- Duque, L.C., and Weeks, J.R., (2010). Towards a model and methodology for assessing student learning outcomes and satisfaction, *Quality Assurance in Education*, 18(2), 84-105.
- Elliott, K.M., and Shin, D., (2002). Student satisfaction: An alternative approach to assessing this important concept, *Journal of Higher Education Policy and Management*, 24(2), 197-209.
- Hagen, P.L., and Jordan, P., (2008). Theoretical foundations of academic advising, *Academic Advising: a Comprehensive Handbook*, 2, 17-35.
- Hennig-Thurau, T., Langer, M. F., and Hansen, U. (2001), "Modeling and managing student loyalty: An approach based on the concept of relationship quality", *Journal of Service Research*, 3(4), 331-344.
- Hon, w., 2002. Applying customer satisfaction theory to community college planning of student services. *Insight in Student Services*, p. Vol. 2.
- Isani, U. A. G., and Virk, M. L. (2005), "Higher education in Pakistan: a historical and futuristic perspective", Islamabad: National Book Foundation.
- Ivy, J. (2001). Higher education institution image: A correspondence analysis approach. *The International Journal of Educational Management*; 15(6), 276-282 .

- Kashif ur Rehman , Babar Zaheer Butt (2010).” A study examining the students satisfaction in higher education”. Islamabad, Pakistan ; Received November 11, 2009; revised December 1, 2009; accepted January 22, 2010.
- Kwek, C., Lau, T., & Tan, H. (2010). Education Quality Process Model and Its Influence on Students’ Perceived Service Quality. *International Journal of Business and Management*, 5(8).
- Lo, C. C. (2010). How student satisfaction factors affect perceived learning. *Journal of the Scholarship of Teaching and Learning*, 10(1), pp. 47-54.
- Mai, L. (2005), “A Comparative Study between UK and US: The Student Satisfaction in Higher Education and its Influential Factors, *Journal of Marketing Management*, 21, 859-878.
- Moore, J.C., (2009). A synthesis of Sloan-c effective practices, *Journal of Asynchronous Learning Networks*, 13(4), 73-97.
- Muhammad Tanveer Afzal, and Munazza Afzal, “Comparison of Students’ Satisfaction and Achievement at Secondary Level in Islamabad.” *American Journal of Educational Research*, vol. 3, no. 12 (2015): 1324-1327. doi: 10.12691/education-3-12-7.
- Nadiri, H., (2011). Strategic issue in higher education marketing: how university students' perceive higher education services, *Asian Journal on Quality*, 7(2), 125-140.
- Napoli, A. R. and Wortman, P. M. (1998), “Psychological factors related to retention and early departure of two-year community college students”, *Research in Higher Education*, 39(4), 419-455.
- Navarro, M. M., Iglesias, P. M. and Torres, R. P. (2005), “A New Management Element for Universities: Satisfaction with the offered courses”, *International Journal of Educational Management*, 19(6), 505-526.

- O'Driscoll, F. (2012). What matters most: An exploratory multivariate study of satisfaction among first year hotel/hospitality management students, *Quality Assurance in Education*, 20(3), 237–258.
- Padma, K. (2006). *Measuring Multidimensional Performance Attributes: Method and Application to Measurement of Service Quality of Local Telephone Companies*. UMI Dissertation Publishing, The Ohio State University Parasuraman, A.
- Palacio, A. B., Menesses, G. D., and Perez Perez, P. J. (2002), "The configuration of the university image and its relationship with the satisfaction of students", *Journal of Educational Administration*, 40(5), 486-505.
- Petruzzellis, L., & Romanazzi, S. (2010). Educational value: how students choose university. *International Journal of Educational Management*. University of Bari Bari, Italy, 24(2), 139-158
- Qureshi, T., Shaukat, M., and Hijazi, S., (2011). Service quality SERVQUAL model in higher educational institutions, what factors are to be considered, *Interdisciplinary Journal of Contemporary Research in Business*, 2(5), 281-290.
- Richardson, J.T.E., (2005). Instruments for obtaining student feedback: A review of the literature, *Assessment and Evaluation in Higher Education*, 30(4), 387-415.
- Salinda Weerasinghe, and R. Lalitha, S. Fernando, "Students' Satisfaction in Higher Education Literature Review." *American Journal of Educational Research*, vol. 5, no. 5 (2017): 533-539. doi: 10.12691/education-5-5-9.
- Terenzini, P. T. and Pascarella, E. T. (1980), "Toward the validation of Tinto's model of college student attrition: A review of recent studies", *Research in Higher Education (Historical Archive)*, 12(3), 271-282.

Tessema, M. T., Ready, K., & Yu, W. C. W. (2012). Factors affecting college students' satisfaction with major curriculum: evidence from nine years of data. *International Journal of Humanities and Social Science*, 2(2).

Yu, Y. and Dean, A. (2001), "The contribution of emotional satisfaction to consumer loyalty", *International Journal of Service Industry Management*, 12(3), 234-250.

Xheladin M.(2005), "Ndryshimet e arsimtarit dhe ndryshimet në shkollë",-Çabej.

Zeithaml, V., Bitner, M., & Gremler, D. (2009). *Service Marketing: Integrating Customer Focus Across the Firm* (5th Ed.), McGraw Hill international, New York.

Shtojca 1: PYETËSOR

Të nderuar pjesëmarrës në anketim,

përpara jush keni një pyetësor i cili përmban disa pyetje të cilat do të përdoren për qëllime akademike , gjegjësisht për temë magjistrature . Plotësimi i pyetësorit do të ju merr vetëm 10-15 minuta kohë, ka natyrë vullnetare dhe përgjigjet tuaja do të jenë komplet anonime dhe të besueshme.Pyetjet kanë të bëjnë me “Satisfaksionin dhe nevojat e nxënësve për të mësuar.Rast studimi-Shkollat e mesme të komunës së Tetovës. “ Ju falemnderit shumë për kohën tuaj! Ju dëshiroj një ditë të mbarë!

Ju lutem rrethoni vetëm njërën nga optionet e mëposhtme.

PARAGRAFI I . TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

1. Gjinia :

- a) Mashkull
- b) Femër

2. Shkolla e mesme në të cilën mësoni :

- a) SHMK Gjimnazi i Tetovës “ Kiril Pejcinoviq”
- b) SHMK Gjimnazi i Dytë “ 7 Marsi “ - Tetovë
- c) SHMKM “ Nikolla Shtejn “ – Tetovë
- d) SHME “ 8 Shtatori” – Tetovë
- e) SHMPK “ Mosha Pijade” – Tetovë
- f) SHMPK “Gjoce Stojçeski” – Tetovë
- g) Shkolla e muzikës “ Todor Skaloski – Tetoec “

3. Viti në të cilin ndjekni shkollimin:

- a) Viti I
- b) Viti II
- c) Viti III

d) Viti IV

4. Suksesi ne vitin paraprak :

- a) Mjaftueshëm
- b) Mirë
- c) Shumë mirë
- d) Shkëlqyeshëm

5. Venbanimi :

- a) Fshat
- b) Qytet

6. A ndikon reputacioni (përshtypja e përgjithshme) i shkollës në satisfaksionin tuaj për të mësuar :

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

7. Nëse do të mundej të ktheheshit prapa në kohë, a do të kishit zgjedhur përsëri shkollën në të cilën mësoni :

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

8. A do t'ua kishit rekomanduar shkollën tuaj ndonjë miku apo ndonjërit nga familja e juaj?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

Në një shkallë prej 1 (plotësisht nuk pajtohem) deri në 5 (plotësisht pajtohem) , ju lutemi rrethoni përgjigjet tuaja të mëposhtme .

PARAGRAFI II. CILËSIA E NDËRVEPRIMEVE ME TË GJITHË PUNONJESIT E SHKOLLËS

1. Profesorët kanë njohuri të gjëra në lëndën e tyre.	1	2	3	4	5
2. Profesorët kanë aftësi të mira mësimore.	1	2	3	4	5
3. Profesorët dhe stafi mbështetës janë të sjellshëm.	1	2	3	4	5
4. Ndihem rehat duke u afruar dhe duke biseduar me profesorët.	1	2	3	4	5
5. Kam mundësinë të marr pjesë në diskutimet në klasë.	1	2	3	4	5
6. Klasat janë të përgatitura mirë dhe të organizuara.	1	2	3	4	5
7. Profesorët dhe stafi mbështetës janë të shqetësuar për mirëqenien dhe interesat e nxënësve.	1	2	3	4	5
8. Profesorët dhe stafi mbështetës i shkollës janë të gatshëm të ndihmojnë në shqetësimet e nxënësve.	1	2	3	4	5
9. Stafi i administratës së shkollës është i sjellshëm, ju siguron ndihmë nxënësve dhe i zgjidh problemet në një kohë të premtuar.	1	2	3	4	5
10. Në përgjithësi, cilësia e ndërveprimeve me të gjithë punonjësit e përfshirë në këtë shkollë është e shkëlqyeshme.	1	2	3	4	5

PARAGRAFI III. CILËSIA E MJEDISIT MËSIMOR NË SHKOLLË

1. Materialet e lëndëve (p.sh tekstet shkollore, doracakët) janë të dobishme.	1	2	3	4	5
2. Materialet e lëndëve janë relevante me lëndën e dhënë.	1	2	3	4	5
3. Materialet e lëndëve janë në përputhje me interesat e nxënësve.	1	2	3	4	5
4. Biblioteka e shkollës ka një koleksion të gjerë librash në dispozicion.	1	2	3	4	5
5. Stafi i bibliotekës ofron informata kthyesë kur kërkohet.	1	2	3	4	5
6. Laboratorët kompjuterikë kanë pajisje cilësore (p.sh hardware,software).	1	2	3	4	5
7. Klasat në të cilat kryhet procesi mësimor janë komforte dhe kanë pajisje cilësore.	1	2	3	4	5

	1	2	3	4	5
8. Salla dhe fusha sportive posedojnë kushte bashkohore .	1	2	3	4	5
9. Hapsirat e shkollës janë të pastërta.	1	2	3	4	5
10. Hapsirat e jashtme të shkollës janë të pastërta.	1	2	3	4	5
11. Në përgjithësi, cilësia e mjedisit mësimor në shkollë është e shkëlqyeshme.	1	2	3	4	5

PARAGRAFI IV. EKSPERIENCA MËSIMORE NË SHKOLLË

1. Gjatë ndjekjes së procesit edukativo-arsimor, kam fituar njohuri të përgjithëshme në fusha të ndryshme.	1	2	3	4	5
2. Kam zhvilluar mendimin tim analitik dhe logjik.	1	2	3	4	5
3. Kam zhvilluar aftësitë e mia të shkrimit dhe të folurit.	1	2	3	4	5
4. Kam zhvilluar një kod personal të vlerave dhe etikës (moralit).	1	2	3	4	5
5. Unë kam përmirësuar aftësitë e mia për të mësuar në mënyrë efektive , për të ndjekur idetë dhe për të gjetur informacionin që kam nevojë.	1	2	3	4	5
6. Unë kam zhvilluar aftësinë për të funksionuar si një anëtar ekipi.	1	2	3	4	5
7. Unë kam arritur suksesin tim të pritur .	1	2	3	4	5
8. Eksperienca e të mësuarit në shkollën time është e shkëlqyeshme.	1	2	3	4	5

PARAGRAFI V. VLERËSIMI I NXËNËSVE DHE VET- VLERËSIMI

1. Kriteret e vlerësimit shpjegohen në fillim të vitit shkollor.	1	2	3	4	5
2. Marr rezultatet / notat e vlerësimit brenda një periudhe të arsyeshme kohore.	1	2	3	4	5
3. Vlerësimi im për arritjet e mia përputhet me atë të profesorit tim.	1	2	3	4	5

- | | | | | | |
|--|---|---|---|---|---|
| 4. Unë jam në gjendje të vlerësoj njohuritë e mia në mënyrë kritike. | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 5. Profesorët nuk bëjnë dallim gjatë vlerësimit të nxënësve. | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

Ju lutem rrethoni vetëm një të një nga opsionet e mëposhtme.

PARAGRAFI VI. VLERËSIMI NË LIDHJE ME NDIKIMIN E FAKTORËVE TJERË RELEVANT ME NDIKIM

1. A organizohen trajnime nga ana e ministrisë së arsimit dhe entit pedagogjik?
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk e di
2. A bëhet selektimi në mënyrë korekte sipas meritës?
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk e di
3. A organizohen pjesëmarrje në projekte nga institucionet e jashtme (p.sh Erasmus)?
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk e di
4. A bëhet selektimi në mënyrë korekte sipas meritës?
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk e di
5. A organizohen gara shkollore në lëmi të ndryshme?
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk e di
6. A jeni të kënaqur me të arriturat e shkollës tuaj në këto gara?
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk e di